



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 377 Akti

Nr. 484 Vendimi  
Tiranë, më 14.12.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Roland Ilia</b>	Relator
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 10.12.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Matilda Llangozi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioner Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Matilda Llangozi, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Berat, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin nëntor të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.
- 4.** Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Matilda Llangozi.
- 5.** Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Matilda Llangozi nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
- 6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
- 7.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
- 8.** Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit me nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2019, i ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*, datë 13.6.2019, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Matilda Llangozi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

**9.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar dy raporte për subjektin e rivlerësimit, njëri me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020 (deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.11.2021, të KDZH-së), dhe një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2021 (deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr.\*\*\*, datë 8.10.2021 të KDZH-së) në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**10.** KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe nga të dhënat arkivore të këtij Këshilli. Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2019, i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2019.

**11.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

**12.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit–vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 11.11.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Matilda Llangozi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**13.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 11.11.2021 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti, pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 22.11.2021.

**14.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit më 7.12.2021, vendosi të ftojë znj. Matilda Llangozi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**15.** Subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 7.12.2021.

**16.** Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 10.12.2021, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

**17.** Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Matilda Llangozi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

---

<sup>1</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**23.** Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të plotë dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Matilda Llangozi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2019, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, duke vënë në dispozicion të Komisionit edhe dosjet me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarim të të ardhurave;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**24.** Znj. Matilda Llangozi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2011, me numër indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private: DPV-në e vitit 2011; DPV-të për vitet 2012 – 2017; dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**25.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

**26.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë në këtë institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë

hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Matilda Llangozi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi \*\*\*, datë 28.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2013 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditetet – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

**Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi ka deklaruar pasuritë si vijojnë:**

### **1. Apartament në pronësi me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, Tiranë**

**1.1** Pasuria apartament banimi me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, në adresën: blv. “\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr.\*\*\*, Tiranë. Vlera: 10,900,000 lekë.

Burimi i krijimit: kontratë shkëmbimi me apartamentin e banimit që ka pasur subjekti dhe bashkëshorti dhe kredi bankare. Data e krijimit 24.11.2014 (kontratë shkëmbimi). Data e kontratës së kredisë 4.12.2014. Zotërimi: 50% pjesë ideale për shkak martesë.

**1.2** Për këtë pasuri rezultoi një kontratë shkëmbimi pasurish të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 24.11.2014, me palë shkëmbyese A dhe E.D dhe bashkëshorti i subjektit J.Ll. Palët shkëmbejnë apartamentet në pronësi të tyre dhe, pas shkëmbimit, shtetasit A dhe E.D marrin në pronësi apartamentin me sip. 79 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*”, Tiranë, ndërsa shtetasi J.Ll merr në pronësi apartamentin me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*” Tiranë.

**1.3** Pala shkëmbyese A dhe E.D dispononte certifikatë për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 30.7.2013, për apartamentin me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë.

**1.4** Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dispononte vërtetim hipotekor datë 27.12.2007, për apartamentin me sip. 79 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, Tiranë.

**1.5** Sipas kontratës së shkëmbimit datë 24.11.2014 rezultoi se palët janë fqinjë dhe me marrëveshje të plotë mes tyre bien dakord të shkëmbejnë pronat midis tyre ku ata janë pronarë, pa asnjë kusht apo kundërshpërblim. Konkretisht, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i jep pasurinë apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, të mobiluar plotësisht dhe përfiton pasurinë me sip. 136 m<sup>2</sup>, të pamobiluar. Të dyja këto pasuri të llojit “apartament” ndodhen në të njëjtën adresë (në të njëjtin pallat).

**1.6** Nisur nga diferenca e sipërfaqes është pyetur subjekti që të deklaronte si janë shkëmbyer këto dy pasuri me sipërfaqe të ndryshme.

**1.7** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: *“Është e mundur, për sa kohë një veprim i tillë juridik nuk është i ndaluar nga ligji dhe se Kodi Civil, që parashikon kontratën e shkëmbimit dhe elementët e saj nuk përcakton si detyrim që pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, të cilat shkëmbehen duhet të kenë domosdoshmërisht sipërfaqe dhe/apo vlerë të njëjtë apo të përafërt me njëra tjetrën.*

*Kontrata e shkëmbimit është një veprim juridik ndërmjet palëve, të cilët kanë rënë dakord për ato kushte të përcaktuara në atë kontratë, pra kanë rënë dakord për shkëmbimin e pasurive përkatëse me sipërfaqet që kanë”.*

**1.8** Është konstatuar se me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 31.10.2014, palët deklaruese J.Ll dhe E.D kanë rënë dakord që të paguhet edhe shuma prej 7,000,000 lekësh nga shtetasi J.Ll (bashkëshorti i subjektit) për të cilën do t'i drejtohej “Societe Generale Albania”, me qëllim kreditimin. Kjo deklaratë noteriale është lëshuar para kontratës së shkëmbimit të pasurive.

**1.9** Për këtë konstatim, subjekti është pyetur që të deklarojë përse nuk është shënuar në kontratën e shkëmbimit kjo vlerë prej 7,000,000 lekësh si kompensim për diferencën në sipërfaqe dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore pranë organeve përkatëse lidhur me vlerën e paguar si kompensim prej 7,000,000 lekësh.

**1.10** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera prej 7,000,000 lekësh nuk është shënuar në kontratën e shkëmbimit, pasi nuk është pjesë e marrëveshjes së palëve në kontratën e shkëmbimit. Palët kanë rënë dakord që të shkëmbehet pasuria me sip. 79 m<sup>2</sup>, e mobiluar tërësisht, me pasurinë me sip. 136 m<sup>2</sup> (vetëm sipërfaqja e ndërtimit). Shtetasi J.Ll ka paguar të gjitha detyrimet që lindin në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse për pozitën që ka pasur për kontratën e shkëmbimit të firmosur në datën 24.11.2014, si dhe është firmosur pagesa prej 12,000 lekësh, si pagesë e kërkuar për kalimin e pronësisë.

**1.11** Rezulton se, për pasurinë apartament me sip. 136 m<sup>2</sup> është bërë rivlerësimi i pronës (rivlerësuar më 23.3.2012, në vlerën 13,337,809 lekë) ku janë paguar detyrimet përkatëse, si dhe janë kryer më pas pagesat për kalimin e pronësisë së pasurive të shkëmbyera.

**1.12** Pasurinë e mëparshme apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, bashkëshorti i subjektit e ka blerë me anë të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 11.12.2007. Sipas kontratës, vlera e blerjes së kësaj pasurie rezulton në shumën 3,900,000 lekë, shumë e cila është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

**1.13** Duke marrë në konsideratë vlerën e blerjes së pasurisë prej 3,900,000 lekësh në vitin 2007 dhe vlerën e paguar prej 7,000,000 lekësh nga kredia e përfituar, vlera e shpenzuar për apartamentin me sip. 136 m<sup>2</sup>, që është në pronësi të subjektit është në shumën e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* prej 10,900,000 lekësh (burimi i deklaruar për pasurinë është kontrata e shkëmbimit dhe kredia bankare).

**1.14** Komisioni hetoi për pasurinë apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 2006 – 2007, e cila është pasuri e shkëmbyer me pasurinë me sip. 136 m<sup>2</sup>, që subjekti dhe bashkëshorti e kanë në pronësi. Edhe pse kjo pasuri është krijuar para fillimit të martesës dhe shumë vite para se subjekti të fillonte funksionet e magjistratit (në tetor të vitit 2012 ka filluar stazhin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) Komisioni kreu disa hetime administrative për këtë pasuri.

**1.15** Rezultoi se bashkëshorti i subjektit, me kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 6.1.2006, ka porositur pasurinë apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, me vlerë 54,000 euro. Pagesa do të bëhej sipas kontratës, e plotë në arkën e objektit ose pranë bankës përkatëse. Nuk rezulton dhe nuk disponohet dokumentacion dhe informacion që të jetë kryer pagesa prej 54,000 euro. Është konstatuar pagesa e kryer në shumën prej 30,000 euro. Konkretisht, z. J.Ll depoziton në datën 6.1.2006, vlerën prej 30,000 euro në llogarinë e BKT-së të shoqërisë “\*\*\*.” sh.p.k. me përshkrimin “derdhje për llogari të ‘\*\*\*’, për blerje apartamenti”. Kontrata e sipërmarrjes dhe më pas e shitblerjes është lidhur vetëm nga bashkëshorti i subjektit.

**1.16** Pas kontratës së sipërmarrjes është formalizuar dhe është lidhur edhe kontrata e shitjes në datën 11.12.2007 (nr. \*\*\*), për blerjen e pasurisë apartament me sip. 79 m<sup>2</sup> nga bashkëshorti i subjektit. Bazuar në këtë kontratë, vlera e blerjes së pasurisë apartament rezulton në shumën 3,900,000 lekë. Vlera e blerjes së pasurisë apartament në vitin 2007 (3,900,000 lekë), përkoi me vlerën 30,000 euro, të paguar nga bashkëshorti i subjektit në datën 6.1.2006.

**1.17** Vlera e pasurisë apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, blerë nga bashkëshorti i subjektit më 6.1.2006, në analizën financiare është vlerësuar me vlerën 30,000 euro (me vlerë të përafërt sipas kursit të këmbimit 3,724,200 lekë).

**1.18** Këtë pasuri apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2011, si pasuri të blerë në vlerën 3,900,000 lekë.

**1.19** Lidhur me mosrakovimin e vlerës së kontratës së sipërmarrjes të datës 6.1.2006, ku është caktuar se do të paguhet në të ardhmen vlera 54,000 euro, ndërsa në kontratën e shitblerjes në datën 11.12.2007 çmimi i shitjes deklarohet 3,900,000 lekë, është pyetur subjekti i rivlerësimit.

**1.20** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: *“Në datën 6.1.2006 midis shtetasit J.Ll dhe R.B, ky i fundit në cilësinë e administratorit të shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr. \*\*\*, për ndërtim apartamenti. Në këtë kontratë është parashikuar vlera e apartamentit të porositur në shumën 54,000 euro dhe afati i kësaj kontrate është data 25.6.2006. Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate nga ana e J.Ll është shlyer shuma 30,000 euro nëpërmjet BKT-së në llogarinë e shoqërisë ‘\*\*\*’ dhe pjesa tjetër është lënë të paguhet në momentin e përfundimit të punimeve. Në datën 11.12.2007 midis shtetasit J.Ll dhe shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. është nënshkruar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme për apartamentin nr. \*\*\*, kati \*\*\*, në rrugën ‘\*\*\*’, me sip. 79 m<sup>2</sup>. Vlera e përcaktuar në këtë kontratë dhe që palët kanë rënë dakord është vlera 3,900,000 lekë dhe që kësaj kontrate i është bashkëngjitur pagesa që është bërë nga J.Ll në datën 6.1.2006, në vlerën 30,000 euro. Palët kanë rënë dakord për këtë vlerë pasi nga ana e ndërtuesit nuk janë respektuar një sërë detyrimesh të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes të datës 6.1.2006 dhe, si e tillë, ka ardhur edhe ulja e vlerës së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes. Ndërtuesi nuk ka kryer një sërë ndërtimesh të brendshme, të cilat ishin marrë përsipër për t’u kryer në kontratën e sipërmarrjes dhe e ka dorëzuar objektin në muajin dhjetor 2007, me vonesë prej 1 viti e gjashtë muaj nga data që ishte marrë përsipër nga ndërtuesi për të dorëzuar objektin. Këto kanë qenë arsyet se përse në momentin e nënshkrimit të kontratës palët kanë rënë dakord për vlerën e përcaktuar në të dhe që realisht është vlera që është paguar në muajin janar të vitit 2006 nga shtetasi J.Ll. Gjithashtu, shtoj se kjo kontratë është nënshkruar kur unë M.Ll nuk kam qenë e martuar me shtetasin J.Ll. Zona ku ndodhej pallati 12-katësh, apartamenti ishte ndërtim i parë dhe i vetëm në atë zonë ku kishte vetëm shtëpi përdhese dhe vlera e tregut në atë periudhë ka variuar nga 40,000 – 45,000 lekë për metër katror”.*

**1.21** Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika, pasi pasuria me sip. 79 m<sup>2</sup> është blerë dhe paguar shitësi nga bashkëshorti i subjektit në datën 6.1.2006, para periudhës së martesës me subjektin e rivlerësimit dhe shumë vite para fillimit të detyrës së magjistratit nga subjekti.

**1.22** Pas shkëmbimit të pasurive të mësipërme rezultoi se bashkëshorti i subjektit është pajisur me kartelë pasurie për apartamentin me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në pronësi të tij, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë.



**1.23** Lidhur me burimin e vlerës 7,000,000 lekë rezultoi se, është lidhur edhe një kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 4.12.2014, me palë kredidhënëse “Societe Generale Albania” dhe palë kredimarrëse J dhe Matilda Llangozi për marrje kredie në vlerën 7,000,000 lekë, ku si garanci lihet apartamenti me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

**1.24** Subjekti, bazuar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: “Shpenzime për pagesën e diferencës që rrjedh nga kontrata e shkëmbimit datë 24.11.2014, si dhe që janë pagesë për të gjitha mobiljet, arredimin, pajisjet elektrike të apartamentit me sip. 136.10 m<sup>2</sup>. Vlera 6,933,000 lekë paguar në favor të E. D në datën 23.12.2014”. Referuar kontratës së shkëmbimit datë 24.11.2014, rezulton se pasuria apartament me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, është e pamobiluar.

**1.25** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: “Ashtu siç kam deklaruar edhe në pyetësorin standard, apartamenti me sip. 136 m<sup>2</sup> në datën 24.11.2014 ka qenë i mobiluar dhe i arreduar tërësisht në të tri dhoma, sallon dhe 2 tualete, por ky mobilim nuk është përfshirë në marrëveshjen midis palëve për shkëmbimin e pasurive të datës 24.11.2014. Palët kanë rënë dakord që të shkëmbej pasuria me sip. 136 m<sup>2</sup> (vetëm si sipërfaqe) me pasurinë me sip. 79 m<sup>2</sup> tërësisht e mobiluar. Pra, nuk kemi bërë mobilim të banesës ku jetojmë aktualisht, por kemi paguar në total të gjithë mobilimin, arredimin, pajisjet elektrike, punimet e kryera në këtë banesë, ku nëpërmjet bankës SGA i është paguar shtetasit E.D vlera prej 6,933,000 lekësh. Pjesa tjetër prej rreth 67,000 lekë është likuiduar cash”.

**1.26** Komisioni e pyeti subjektin lidhur me mosrakovimin e qëllimit të përfitimit të kredisë dhe destinacionit të përdorimit.

**1.27** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: “Në kontratën e shkëmbimit palët kanë rënë dakord për të shkëmbyer apartamentin me sip. 79 m<sup>2</sup> në gjendje të mobiluar me sipërfaqen e apartamentit 136 m<sup>2</sup> (vetëm sipërfaqja). Ky është parashikimi në kontratë dhe për këtë palët kanë rënë dakord. Vlera prej 7,000,000 lekësh nuk është shënuar në kontratën e shkëmbimit, pasi nuk është pjesë e marrëveshjes së palëve në kontratën e shkëmbimit. Ndërsa në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, të datës 31.10.2014, që është nënshkruar vetëm ndërmjet E.D dhe J.Ll është shënuar shuma 7,000,000 lekë si diferencë në metra katrorë, vlerë për të cilën J. Ll do t’i drejtohet bankës SGA me qëllim kreditimin e kësaj vlere. Shënimet nuk kanë reflektuar marrëveshjen që palët kanë finalizuar në datën 24.11.2014, rreth një muaj më vonë. Përkundrazi, ky lloj shënimi ka qenë i imponuar nga ana e bankës për rastet që ata kanë për dhënien e kredive”.

**1.28** Është vërtetuar se me anë të urdhërshirimit nga “Societe Generale Albania”, datë 23.12.2014, shtetasi J.LL kalon shumën prej 6,933,000 lekësh në favor të shtetasit E.D.

**1.29** Nga sa më sipër, në tabelën vijuese, analizohet mundësia e subjektit dhe bashkëshortit për pagesën e vlerës 7,000,000 lekë për shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Kredi në “Societe General Alania” më 23.12.2014	6,933,000
Cash	67,000
<b>Total</b>	<b>7,000,000</b>
Vlera e shkëmbimit të apartamenteve	7,000,000
<b>Mbulimi</b>	<b>100%</b>

**1.30** Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2011, subjekti ka deklaruar të ardhurat familjare nga puna e përbashkët bashkëshortore, por në deklaratën Vetting nuk ka deklaruar të ardhurat e krijuara para vitit 2011 (para fillimit të detyrës). Për këtë është

pyetur subjekti, e cila ka sjellë dokumentacion lidhur me të ardhurat e krijuara prej saj dhe bashkëshortit para vitit 2011.

**1.31** Lidhur me të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit para fillimit të detyrës (para vitit 2011), mënyra e llogaritjes është trajtuar te metodologjia e përdorur nga Komisioni në pikën 11 të vendimit.

**1.32** Komisioni konstatoi se, pasuria me sip. 136 m<sup>2</sup> është përfituar nga pala shkëmbyese A dhe E.D para vitit 2012. Në datën 23.3.2012, këta shtetas kanë bërë edhe rivlerësimin e kësaj pasurie në vlerën 13,337,809 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, në janar të vitit 2014.

**1.33** Komisioni hetoi edhe për konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit me palën shkëmbyese të pasurisë A dhe E.D.

Bazuar në shkresat nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar çështje gjyqësore me palën shkëmbyese A dhe E.D.

#### **1.34 Në përfundim të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se:**

- Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar saktë pasurinë me sip. 139 m<sup>2</sup> dhe burimin e krijimit, pasi kjo pasuri apartament rezultoi se, është krijuar nga shkëmbimi me pasurinë apartament me sip. 79 m<sup>2</sup> dhe nga vlera prej 7,000,000 lekësh, e përfituar si kredi bankare.
- Pasuria e shkëmbyer me sip. 139 m<sup>2</sup> është përfituar nga pala shitëse para vitit 2012 (në vitin 2012 është bërë rivlerësimi i saj) dhe nuk u konstatua konflikt interesi të subjektit të rivlerësimit me palën shkëmbyese të pasurisë.
- Rezultuan disa pasaktësi lidhur me veprimet dhe deklaratimet për pasurinë apartament që kanë pasur me sip. 79 m<sup>2</sup> dhe shkëmbimin me pasurinë me sip.139 m<sup>2</sup>, të përmendura më sipër në pikën 1 të vendimit.
- Kontrata e shkëmbimit e datës 24.11.2014, për përfitimin e pasurisë apartament me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, nuk përcakton asnjë detyrim financiar, por vetëm shkëmbim të plotë midis dy pasurive të paluajtshme. Kjo kontratë nuk ka reflektuar veprimin e subjektit dhe bashkëshortit të përcaktuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 31.10.2014 me palë deklaruese J.Ll dhe E.D, të cilët kanë rënë dakord që të paguhet shuma prej 7,000,000 lekësh, e cila do të përfitohet me kredi bankare.

**1.35** Për sa më sipër, në lidhje me rezultatet e hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit**

**1.36** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, sqaroi se: *“Që prej vitit 2006 dhe deri në vitin 2014 bashkëshorti ishte pronar dhe posedonte apartamentin e ndodhur në rrugën ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, me sip. 79 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, e ndodhur në z. k. \*\*\*, Tiranë. Në këtë banesë jetonim unë, bashkëshorti dhe vajza. Në kushtet kur familja që prej shkurtit të vitit 2012 ishte zgjeruar me 4 anëtarë, atëherë ne si bashkëshortë kemi qenë në kërkim të një apartamenti me sipërfaqe më të madhe. Në të njëjtin pallat ku ne jetonim, çifti i bashkëshortëve A dhe E. D, të cilët kishin në pronësi një apartament me sip. 136.10 m<sup>2</sup> kanë shfaqur interesin për të bërë shkëmbimin e pasurisë së tyre me pasurinë tonë për shkak se kanë qenë të interesuar për një banesë me sipërfaqe më të vogël. Pas zhvillimit të bisedimeve ndërmjet tyre dhe bashkëshortit tim është rënë dakord në formë verbale që të dy pasuritë do të shkëmbeheshin ndërmjet tyre. Pjesë e kësaj marrëveshjeje verbale (pra, bisedimet që zhvillohen përpara kryerjes së veprimeve juridike) ka qenë edhe fakti që apartamenti me sip. 79 m<sup>2</sup> do të dorëzohej*

tërësisht i mobiluar dhe në atë gjendje që ishte. Kjo marrëveshje presupozonte që apartamenti me sip. 79 m<sup>2</sup> së bashku me vlerën e mobilieve, punimeve, pajisjeve hidrosanitare dhe çdo orë tjetër të asaj banese do t'i përafrohej vlerës që kishte apartamenti me sip. 136.10 m<sup>2</sup>. Ndërkohë në kushtet kur çifti i bashkëshortëve E dhe A.D do të bëheshin pronarë të një banese me sipërfaqe më të vogël dhe tërësisht të mobiluar atëherë ata bënë përpjekje për t'u arritur marrëveshja verbale që edhe çdo punim, mobilim, arredim i sallonit, 3 dhomave, 2 banjove, korridorit dhe ballkonit dhe këtu futen edhe detaje të tilla si deri tek perdet apo edhe pikturat dhe zbukurimet e mureve, të vlerësohej kundrejt një vlere, në mënyrë që ne të mos bënim mobilim tjetër dhe ata të mos merrnin asnjë orë nga banesa e tyre. Në lidhje me sa më sipër, midis bashkëshortit tim dhe E.D u ra dakord (verbalisht) që të gjitha këto mobilime, punime, arredime etj., të vlerësoheshin në masën prej 7,000,000 lekësh.

Duke qenë komshinj në të njëjtin pallat prej disa vitesh, midis palëve kishte besim dhe mirëkuptim në arritjen e këtyre marrëveshjeve. Në muajt nëntor-dhjetor të vitit 2014 unë dhe bashkëshorti im ishim në pamundësi për të përballuar financiarisht pagesën e shumës prej 7,000,000 lekësh. E vetmja alternativë për të siguruar këtë shumë ishte t'i drejtoheshim bankave për marrjen e kredisë në vlerën 7,000,000 lekë. Bazuar në alternativat që kishin bankat për financimin e kësaj shume, ku këto të fundit kreditonin vetëm për blerje pasurie të patundshme, midis palëve J.LL dhe E.D është nënshkruar deklarata noteriale me nr. \*\*\*, të datës 31.10.2014, ku në përmbajtje të saj ndër të tjera është përcaktuar edhe se: E bëjmë këtë deklaratë noteriale që ta paraqesim pranë bankës së nivelit të dytë 'Societe Generale', me qëllim kreditimi për deklaruesin z. J.LL të vlerës së sipërpërmendur. Shënimeve të bëra në këtë deklaratë nuk iu është kushtuar vëmendja e duhur dhe ato nuk kanë reflektuar marrëveshjen që palët e finalizuan me kontratën e shkëmbimit në datën 24.11.2014, pra rreth një muaj më vonë, pasi qëllimi i palëve ka qenë kreditimi i shumës prej 7,000,000 lekësh. Ky lloj shënimi i bërë 'si diferencë në metra katrorë', ka qenë edhe e imponuar nga ana e bankës për t'u përputhur me rastet që ata kanë për dhënien e kredive.

Në datën 24.11.2014, midis palëve J.LL nga njëra anë dhe E dhe A.D nga ana tjetër u realizua veprimi juridik i shkëmbimit të dy pasurive përkatëse të llojit apartament sipas asaj marrëveshjeje verbale të arritur midis tyre dhe që është shprehur në kontratën me nr.\*\*\*, të datës 24.11.2014 dhe ku thuhet se, palët kanë rënë dakord se: 'Palët e mësipërme janë komshinjë dhe me marrëveshje të plotë mes tyre bien dakord të shkëmbejnë pronat e mësipërme ku ata janë pronarë, pa asnjë kusht apo kundërshtim dhe konkretisht: bashkëpronarët A dhe E.D i japin në pronësi pronarit J.LL apartamentin e tyre të pajisur ose thënë ndryshe bosh, të ndodhur në rrugën '\*\*\*', p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\* të pasurisë të ndodhur në z. k. nr. \*\*\*, Tiranë, vol. 17, f. 22. Ndërsa pronari J.LL i jep në pronësi bashkëpronarëve A dhe E.D apartamentin e tij të pajisur cilësisht dhe tërësisht të ndodhur në rrugën '\*\*\*', p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me sip. 79 m<sup>2</sup> me nr. \*\*\* të pasurisë, e ndodhur në z. k. \*\*\*, Tiranë, vol. \*\*\*, f. \*\*\*.

Në kontratën e shkëmbimit nuk është shënuar vlere prej 7,000,000 lekësh, pasi kjo e fundit jo vetëm që ka qenë pagesë për të gjithë investimet e bëra në atë banesë (sende të luajtshme) dhe nuk mund të shënohej në një kontratë shkëmbimi, ku palët kanë rënë dakord për të shkëmbyer pasuritë e paluajtshme dhe që ishin apartamentet përkatëse, por edhe për faktin se në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, kjo shumë nuk ishte kaluar ende në favor të palës E.D. Mobilimi, arredimi, kryerja e punimeve, e instalimeve, hidrosanitet, elektroshtëpiaket dhe çdo gjë tjetër që gjendej në apartament është rënë dakord midis palëve E.D dhe J.LL në datën 30.10.2014 (kur është nënshkruar deklarata noteriale) se do të vlerësoheshin 7,000,000 lekë dhe do të paguheshin në momentin pas nënshkrimit të kontratës së shkëmbimit për pasuritë përkatëse, si dhe pas akordimit të shumës së kredisë nga banka 'Societe General Albania'.

*Pagesa në favor të E.D është bërë në datën 23.12.2014 (provuar me dokumentin bankar të lëshuar në datën 23.12.2014 nga banka 'Societe Generale Albania').*

*Në këtë kontratë, shkëmbimi është shënuar që apartamenti me sip. 79 m<sup>2</sup> është tërësisht i mobiluar më mënyrë bashkëkohore dhe apartamenti prej 136.10 m<sup>2</sup> është tërësisht bosh (pra shkëmbehet vetëm sipërfaqja e këtij të fundit). Palët në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk kanë bërë një vlerësim të mobilimit dhe të arredimit të apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup>, por e kanë shënuar si pjesë të marrëveshjes së shkëmbimit të pasurive. Siç e kam thënë edhe për përgjigje të pyetësorëve të mëparshëm, vlera prej 7,000,000 lekësh nuk është shënuar në kontratën e shkëmbimit pasi nuk është pjesë e marrëveshjes së palëve në këtë kontratë. Palët kanë rënë dakord që të shkëmbehen pasuria me sipër 79 m<sup>2</sup> e mobiluar tërësisht me pasurinë me sip. 136 m<sup>2</sup> (vetëm sipërfaqja).*

*Legjislacioni shqiptar dhe konkretisht Kodi Civil, i cili parashikon edhe kontratën e shkëmbimit dhe elementet e saj, nuk përcakton si detyrim që pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, të cilat shkëmbehen duhet të kenë domosdoshmërisht sipërfaqe dhe/apo vlerë të njëjtë apo të përafërt me njëra-tjetrën.*

*Vlera prej 7,000,000 lekësh është paguar për të gjithë mobilimin, arredimin dhe punimet e brendshme që janë bërë në pasurinë me sip. 136 m<sup>2</sup>. Në pyetësorin standard si përgjigje e pyetjes nr. 9 kam deklaruar kryerjen e shpenzimit prej 6,933,000 lekësh në favor të E.D që janë pagesë për të gjitha mobiliet, arredim, pajisje elektrike të apartamentit me sip.136.10 m<sup>2</sup>, duke bashkëngjitur edhe mandatin përkatës të pagesës nëpërmjet bankës për këtë shumë. Ndërsa pjesa tjetër prej 67,000 lekësh është paguar cash.*

*Gjithashtu, fakti se palët E dhe A.D kanë bërë një rivlerësim të pasurisë në vitin 2012 dhe shtetasi J.Ll nuk e ka bërë këtë rivlerësim pasurie nuk do të thotë se vlera e pasurisë me sip. 79 m<sup>2</sup> është në masën 3,900,000 lekë. Sipas çmimeve të referencës në vitin 2014 pasuria me sip. 79 m<sup>2</sup> ka pasur një vlerë prej 79 m<sup>2</sup> x 98,000 lekë = 7,742,000 lekë. Kësaj shifre po t'i shtohet edhe vlera e mobilimit dhe arredimit bën edhe përafrimin e vlerës së kësaj pasurie me vlerën e apartamentit me sip. 136.10 m<sup>2</sup>, si sipërfaqe bosh pasi mobiliet e saj, arredimi dhe çdo investim tjetër është vlerësuar në shumën prej 7,000,000 lekësh, shumë e cila është paguar në rrugë bankare në favor të E.D dhe që kjo shumë është financuar nga ana e bankës 'Societe Generale' në bazë të kontratës së kredisë së datës 4.12.2014.*

*Nga ana e J. Ll janë paguar të gjitha detyrimet që lindin në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse për pozitën që ka pasur në bazë të kontratës së shkëmbimit të datës 24.11.2014. Në datën 24.11.2014 pranë ZVRPP-së Tiranë është kryer nga J.Ll pagesa në vlerën 12,000 lekë si pagesë e kërkuar për kalimin e pronësisë. Kjo zyrë, pasi ka verifikuar përmbajtjen e kontratës së shkëmbimit ka bërë edhe kalimin e pronësisë për pasurinë me nr. \*\*\*, me sip.136.10 m<sup>2</sup> në favor të J.Ll. Nuk kam dijeni dhe nuk jam informuar nga ndonjë institucion për ndonjë detyrim tjetër që duhet të paguante J.Ll në kuadër të kalimit të pronësisë”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.37** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti argumente dhe prova bindëse që qartësojnë mënyrën e shkëmbimit të dy pasurive apartament me sipërfaqe përkatësisht 79 m<sup>2</sup> dhe 139 m<sup>2</sup>, ndërmjet dy palëve shkëmbyese: A dhe E.D dhe J.Ll. Diferencën prej 7,000,000 lekësh, palët nuk e kanë cituar në kontratën e shkëmbimit të datës 24.11.2014 për shkak se kjo shumë u vërtetua se është kredituar një muaj më vonë në favor të shtetasve A dhe E.D, si diferencë për arredimin dhe mobilimin e apartamentit me sip. 139 m<sup>2</sup>.

**1.38** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit, me gjithë pasaktësinë e bërë në lidhje me mobilimin dhe arredimin e apartamentit me sip. 139 m<sup>2</sup> nuk krijon dyshime të tjera dhe nuk ndikon në vlerësimin përfundimtar të subjektit në lidhje me deklarimin e pasurisë së saj dhe personave të lidhur të saj.

**1.39** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë bërë deklaram të saktë dhe kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

## **2. Pasuri tokë arë me sip. 1.500 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë**

**2.1** Subjekti ka deklaruar sipërfaqe toke prej 1.500 m<sup>2</sup>, e llojit “arë”, ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*\*, në \*\*\*, Tiranë. Vlera: 649,500 lekë. Burimi i krijimit: kursimet familjare. Data e krijimit 10.7.2015 (deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 10.7.2015, si dhe kontrata e shitjes me nr. \*\*\*, datë 12.12.2015). Zotërimi: 50% pjesë ideale për shkak martesë.

**2.2** Për këtë pasuri rezultoi kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 12.12.2015, me palë shitëse B.S etj., dhe palë blerëse J.Ll për blerje tokë arë, me sip. 1.500 m<sup>2</sup>, \*\*\*, Tiranë, në vlerën 649,500 lekë – e likuiduar. Pjesë përbërëse e kontratës rezultoi edhe deklarata noteriale e datës 10.7.2015.

**2.3** Më anë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 10.7.2015, shtetasit B.S etj., deklarojnë se kanë rënë dakord që t’i shesin një pjesë prej 1.500 m<sup>2</sup> nga toka bujqësore në \*\*\*, Tiranë, shtetasit J.Ll për shumën 649,500 lekë, shumë e marrë jashtë zyrës noteriale e plotë. Kontrata e shitblerjes së pasurisë do të lidhet pas një jave nga momenti i nënshkrimit të kësaj deklaratë.

**2.4** ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit për këtë pasuri është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie nr.\*\*\*, datë 17.12.2015. Pasuria rezulton tokë arë me sip.1.500 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit J.Ll, si dhe kartela e pasurisë shoqëruar me të dhëna të njëjta.

**2.5** Vlera e blerjes në vitin 2015 e tokës arë me sip. 1.500 m<sup>2</sup>, \*\*\* (\*\*\*), Tiranë, rezultoi prej 433 lekë/m<sup>2</sup>. Bazuar në VKM-në nr. 514, datë 30.7.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, vlera e tokës bujqësore për fshatin \*\*\* rezultoi 499 lekë/m<sup>2</sup>.

**2.6** Bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (vendim i cili është në fuqi edhe sot) vlera e tokës bujqësore për fshatin \*\*\* rezultoi 231 lekë/m<sup>2</sup>.

**2.7** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me pyetjen e bërë nga Komisioni për blerjen e kësaj prone dhe çfarë investimesh janë bërë mbi këtë pasuri që nga momenti i blerjes e deri tani, ka deklaruar se: *“Blerja e kësaj prone nga ana e bashkëshortit tim është parë si mundësi investimi i të ardhurave që ne kemi realizuar ndër vite, pra investim në blerje të pasurive të paluajtshme. Që nga blerja e deri tani është investuar në mbjelljen e 20 fidanëve ullinj dhe disa fidanë të pemëve frutore të ndryshëm dhe vlera e këtij investimi shkon rreth 15,000 lekë”.*

**2.8** Pavarësisht se vlera e blerjes së kësaj pasurie rezultoi më e madhe se vlera referuese e aktit normativ të Këshillit të Ministrave, Komisioni pyeti subjektin të provojë mospasjen e konfliktit të mundshëm të interesit me palët shitëse. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti risqaroi se nuk ka pasur çështje gjyqësore me palën shitëse.

**2.9** Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me palën shitëse. Bazuar në shkresat nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar çështje gjyqësore me palën shitëse të pasurisë tokë arë.

**2.10** Analiza e mundësisë së blerjes së tokës arë, datë 10.7.2015

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura Matilda Llangozi 1.1.2015 – 10.7.2015	626,795
Të ardhura J.Ll 1.1.2015 – 10.7.2015	1,367,443
<b>Të ardhura totale 1.1.2015 – 10.7.2015</b>	<b>1,994,238</b>
Shpenzime jetese 1.1.2015 – 10.7.2015	485,931
Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2015 – 10.7.2015	150,000
Shpenzim sigurim jete Sigal J.Ll	140,403
Shpenzime transport Tiranë - Berat - Tiranë	108,333
Shpenzim blerje TV	169,900
Shpenzime për kredi 1.1.2015 – 10.7.2015	290,919
Shpenzime udhëtimi 1.1.2015 – 10.7.2015	42,501
Blerje tokë arë 1,500 m <sup>2</sup> – 10.7.2015	649,500
<b>Shpenzime totale 1.1.2015 – 10.7.2015</b>	<b>2,037,488</b>
<b>Ndryshimi në likuiditete 31.12.2014 – 10.7.2015</b>	<b>22,401</b>
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-65,651</b>

**2.11** Në përfundim të rezultateve të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se:

- Duket se subjekti nuk ka burime të ligjshme për blerjen e pasurisë tokë arë në vitin 2015, pasi rezultoi me një pamundësi financiare në shumën 65,651 lekë.
- Vlera e blerjes dhe investimi prej 15,000 lekësh mbi këtë pasuri, sipas përgjigjes së subjektit, është shtuar te pasuritë e subjektit për vitin 2015.

**2.12** Për sa më sipër, në lidhje me rezultatet e Komisionit, subjekti të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**Qëndrimi i subjektit**

**2.13** Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se, për pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në shumën prej 65,651 lekësh, në momentin e blerjes kjo pamundësi nuk ka ekzistuar. Puna e bashkëshortit tim, që ka të bëjë me tregtimin e barnave farmaceutike, bën që ai të ketë gjendje likuiditeti në mënyrë të vazhdueshme dhe në sasi relativisht të konsiderueshme. Në përgjigje të kësaj pyetjeje sjell në vëmendje se bazuar edhe në hetimin që ju keni realizuar (të detajuar në pikën 5.9 të raportit, ku janë analizuar të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortit) rezulton se për vitin 2015 aktiviteti i bashkëshortit ka realizuar një xhiro vjetore në masën 20,830,294 lekë, pra rreth 200 milionë lekë të vjetra xhiro. Kjo shumë, nëse pjesëtohet me 12 muaj të vitit rezulton se xhiroja mujore mesatare ka qenë rreth 1,735,857 lekë, pra rreth 17 milionë lekë të vjetra/muaj. Pra, kjo shumë që është xhiroja mesatare mujore e ka përballuar më së miri edhe vlerën prej 65,651 lekësh për të realizuar blerjen e pasurisë së llojit arë me sip. 1500 m<sup>2</sup>”.*

## Vlerësimi i Komisionit

**2.14** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, sqaroi se në momentin e blerjes kjo pamundësi nuk ka ekzistuar për shkak se puna e bashkëshortit ka të bëjë me tregtimin e barnave farmaceutike, duke përbulluar më së miri edhe vlerën prej 65,651 lekësh për të realizuar blerjen e pasurisë së llojit “arë” me sip. 1.500 m<sup>2</sup>.

**2.15** Mënyra e llogaritjes së të ardhurave mujore të biznesit në analizën financiare nga Komisioni u hartua duke pjesëtuar fitimin vjetor *neto* dhe jo xhiron vjetore me 12 muaj. Komisioni nuk mund të llogarisë saktë të ardhurat e subjektit fizik për periudhën 1.1.2015 - 10.7.2015 (gjendjen e likuiditeteve *cash*, shumat në arkë etj.,) pasi ky lloj aktiviteti llogaritet në bazë të xhiros vjetore. Duke marrë në konsideratë xhiron vjetore të bashkëshortit të subjektit për vitin 2015, të ardhurat *neto* vjetore prej 2,362,498 lekësh, për Komisionin nuk konstatohen pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 649,500 lekë.

**2.16** Gjithsesi, Komisioni vlerësoi se edhe nëse nuk do të merreshin në konsideratë shpjegimet e subjektit, pamundësia financiare prej 65,651 lekësh, nuk është e konsiderueshme që të përbëntë shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

**2.17** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë bërë deklaram të saktë dhe se kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2015.

### 3. Automjet tip “\*\*\*\*”, në vlerën 5,000 euro

**3.1** Subjekti ka deklaruar automjet tip “\*\*\*\*”, viti i prodhimit 2004. Vlera: 5,000 euro. Burimi i krijimit: shitja e automjetit të mëparshëm (tip “\*\*\*\* \*\*\*\*”). Data e blerjes 2.5.2014. Zotërimi: 50 % pjesë ideale për shkak martesë.

**3.2** Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip ‘\*\*\*’, në vlerë 5,000 euro. Data e blerjes 2.5.2014. Burimi nga shitja e automjetit të mëparshëm tip ‘\*\*\*’. Të ardhura nga shitja e automjetit 5,000 euro*”.

**3.3** Rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.5.2014, bashkëshorti i subjektit ka blerë nga pala shitëse B.N automjetin tip “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\* JB, me vlerë 5,000 euro.

**3.4** Ky automjet është blerë nga pala shitëse në datën 31.3.2014, në vlerën 7,000 euro dhe disa ditë më vonë i është shitur bashkëshortit të subjektit në vlerën 5,000 euro. Mbetej i dyshimtë fakti se nga pala shitëse, disa ditë pas blerjes, ky automjet shitet me vlerë më të ulët të bashkëshorti i subjektit.

**3.5** Lidhur me këtë konstatim, subjekti është pyetur për të dhënë shpjegime lidhur me vlerat e blerjes dhe shitjes së automjetit që ka pasur në pronësi bashkëshorti dhe ndonjë konflikt të mundshëm interesi.

**3.6** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: “*Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.5.2014, B.N i ka shitur J.Ll automjetin tip ‘\*\*\*’ në vlerën 5,000 euro. Në momentin që është blerë automjeti ka pasur nevojë për shërbime xhenerike dhe motorike dhe, për këtë arsye, është vlerësuar me këtë çmim shitjeje. Brenda vitit 2014 janë kryer dy herë servis automjetit në një servis të Tiranës sipas zërave të shënuar në fletën përkatëse me vlerë shpenzimi 262,000 lekë, të paraqitur si dokument provues. Ndërsa për lidhjen me palën shitëse, subjekti deklaroi se as unë dhe as bashkëshorti im nuk kemi asnjë lidhje përveç marrëdhënies juridike të krijuar për blerjen e automjetit dhe se në dijeninë time asnjëherë nuk kam pasur çështje të gjykuar në lidhje me këtë palë gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat*”.

**3.7** Ndërsa pyetjes në lidhje me faktin se një automjet i blerë në vlerën 5,000 euro në vitin 2014, është rishitur më pas në një vlerë më të madhe, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se: *“Në bazë të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, të datës 18.5.2017, rezulton se J.Ll i ka shitur palës blerëse E. T automjetin tip ‘\*\*\*’, në vlerën 6,800 euro. Palët kanë rënë dakord për këtë vlerë duke qenë se automjeti ishte në kushte optimale teknike dhe motorike. Diferenca prej 1,800 euro ndërmjet çmimit të blerjes dhe atij të shitjes reflekton shpenzimet e bëra gjatë viteve, të cilat kanë sjellë përmirësimin e automjetit krahasuar me momentin që është blerë”*.

**3.8** Bazuar në fletëdaljen e lëshuar në datat 7.6.2014 dhe 20.11.2014, rezulton se automjetit tip “\*\*\*”, me targa AA \*\*\*JB, i janë bërë 2 shërbime me vlera 136,000 lekë dhe 126,000 lekë (në total 262,000 lekë). Këto shpenzime janë përfshirë në analizën financiare për vitin 2014.

**3.9** Rezultoi se me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 18.6.2014, bashkëshorti i subjektit J.Ll i shtet palës blerëse A.M, automjetin tip “\*\*\* E \*\*\* CDI”, me targa TR \*\*\* U, në vlerën 5,000 euro për të cilin nuk ka paraqitur kontratën e blerjes.

**3.10** Lidhur me automjetin tip “\*\*\* E \*\*\* CDI”, me targa TR \*\*\*U, pas përgjigjes nga DPSHTRR-ja, rezultoi se është blerë nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2009 në vlerën 300,000 lekë. Gjithashtu rezultoi se janë paguar edhe detyrimet doganore në vlerën 462,749 lekë në vitin 2010. Pra, vlera totale për blerjen e këtij automjeti dukej se ishte 762,749 lekë.

**3.11** Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2011 ky automjet është deklaruar i blerë nga subjekti në vlerën 500,000 lekë. Duket se ky deklarim i subjektit nuk përkon me kontratën e shitjes dhe as pagimin e detyrimeve të tjera për këtë automjet.

**3.12** Për mosrakovimin e deklarimit të vlerës në DPV-në e vitit 2011 është pyetur subjekti ku ka deklaruar: *“Në DPV-në e vitit 2011 në deklarimin për herë të parë është bërë një gabim material nga ana ime. Gabimisht kam hedhur vlerën e një automjeti tjetër që bashkëshorti im ka pasur më përpara (automjet i ngjashëm)”*.

**3.13** Subjekti është pyetur se përse nuk përkon vlera e kontratës me vlerën e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2011, si dhe sa ka qenë vlera reale e blerjes së këtij automjeti.

**3.14** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: *“Shënimi në DPV para fillimit të detyrës në vitin 2011 të vlerës së blerjes së këtij automjeti 500,000 lekë është bërë gabimisht për shkak të një blerjeje tjetër për një automjet të ngjashëm dhe këtë gabim nuk e kam korrigjuar ndonjëherë sepse në deklaratën Vetting ky deklarim nuk është përsëritur duke qenë se aty deklarohen pasuritë në momentin e plotësimit të deklaratës. Ndërsa, bazuar kontratës së shitblerjes me nr. \*\*\*, të datës 2.4.2009, vlera e blerjes së këtij automjeti nga bashkëshorti im është 300,000 lekë. Më pas është kryer pagesa e vlerës së zhdoganimit të automjetit 465,000 lekë”*.

**3.15** Gjithashtu, subjekti është pyetur se si është e mundur që një automjet i blerë në vitin 2009 me kontratë në vlerën 300,000 lekë shitet disa vite më vonë (në vitin 2014) në vlerën 5,000 euro.

**3.16** Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Automjeti është blerë në vitin 2009 në shumën 300,000 lekë dhe në vitin 2010 është paguar edhe vlera e zhdoganimit në shumën 465,930 lekë, pra, shuma total ka shkuar 765,000 lekë. Në vitin 2014, në bazë të kontratës me nr. \*\*\*, të datës 18.6.2014, ky automjet është shitur në shumën 5,000 euro dhe sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë rezulton se shuma prej 5,000 euro konvertohet në rreth 700,000 lekë. Pra jo vetëm që nuk është shitur me fitim, por nën vlerën që ka kushtuar realisht”*. Pyetjes nëse janë paguar detyrimet tatimore që rrjedhin nga shitja e automjetit me një vlerë më të lartë



se ajo e blerjes, subjekti i përgjigjet se *ky automjet nuk është shitur me vlerë më të lartë se ajo që është blerë.*

**3.17** DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2017 dhe nr.\*\*\* prot., datë 3.7.2020, ka konfirmuar se shtetasi J.Ll ka pasur në pronësi automjetin me targa AA \*\*\* JB deri më 19.5.2017, ndërsa automjetin me targa TR \*\*\* U e ka pasur në pronësi deri më 20.6.2014.

**3.18** Subjekti është pyetur lidhur me mosrakovimin e datës së shitjes së automjetit tip “\*\*\*\* E \*\*\*\*” me datën e blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” në vitin 2014.

**3.19** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar: *“Automjeti tip ‘\*\*\*’ është blerë nga ana e bashkëshortit tim J.Ll në datën 2.5.2014 dhe si burim për blerjen e tij kanë shërbyer sasia monetare e përfituar nga shitja e automjetit ‘\*\*\*’. Këtë e kam deklaruar si në deklaratën periodike të deklarimit të interesave për vitin 2014 ashtu edhe në deklaratën Vetting. Shitja e automjetit ‘\*\*\*’ nga ana e J. Ll është bërë në muajin prill të vitit 2014, ku shtetasi A.M (blerësi i këtij automjeti) ka paguar shumën e rënë dakord për blerje dhe ka marrë automjetin që në muajin prill 2014 (fundi i muajit). Për arsye objektive të të dyja palëve (shitesit J dhe bleresit A) kontrata nuk u mundësua të përpilohej në momentin e bërjes së pagesës dhe dorëzimit të sendit, por u realizua rreth një muaj e pak me vonësë dhe konkretisht në datën 18.6.2014. Bashkëngjitur po ju paraqes deklaratën noteriale me nr. \*\*\*, të datës 20.9.2021, të nënshkruar nga A.M (blerësi i automjetit ‘\*\*\*’).”*

**3.20** Bazuar në deklaratën noteriale të datës 29.9.2021, deklaruesi A.M ka deklaruar se: *“Në muajin prill 2014 kam kontaktuar me z. J.Ll, i cili kishte nxjerrë njoftimin për shitjen e një automjeti tip ‘\*\*\*’. Pas bisedimeve ne ramë dakord për blerjen e këtij automjeti në shumën 5,000 euro, shumë e cila është paguar nga ana ime cash dorazi në muajin prill 2014 dhe automjeti më është dorëzuar mua po në këtë muaj nga ana e z. J.Ll. Për shkak të disa problemeve të mia, si dhe arsye objektive të J kontrata është mundur të realizohet një muaj e ca me vonësë”*.

**3.21** Nga sa më sipër, në tabelën vijuese, analizohet mundësia e subjektit dhe bashkëshortit për pagesën e vlerës 5,000 euro për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” në vitin 2014.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në euro</b>
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****” - 5,000 euro	5,000
<b>Total</b>	<b>5,000</b>
Blerje automjeti tip “****” - 5,000 euro	5,000
<b>Mbulimi</b>	<b>100%</b>

**3.22** Në përfundim të rezultateve të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se:

- Për pasurinë tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2014, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaratimet e subjektit, vlerën e blerjes apo konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me palët shitëse dhe blerëse të automjetit.
- Si burim për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” kanë shërbyer të ardhurat në vlerë 5,000 euro nga shitja e automjetit tip “\*\*\*\*”, me targa TR \*\*\* U, por ka mosrakovim të datës së shitjes së këtij automjeti me datën e blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”.
- Bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 vlerën e saktë për blerjen e automjetit në vitin 2009 (deklaruar në vlerën 500,000 lekë kundrejt vlerës së shpenzuar gjithsej prej 765,000 lekësh).

**3.23** Për sa më sipër, në lidhje me rezultatet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit**

**3.24** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi se: *“Automjeti tip ‘\*\*\*’ është blerë nga ana e bashkëshortit tim J. Ll në datën 2.5.2014 dhe si burim për blerjen e tij kanë shërbyer shuma monetare e përfituar nga shitja e automjetit tip ‘\*\*\*’. Këtë e kam deklaruar si në DPV-në e vitit 2014, ashtu edhe në deklaratën Vetting. Shitja e automjetit tip ‘\*\*\*’ nga ana e J.Ll është bërë në muajin prill të vitit 2014, ku shtetasi A.M (blerësi i këtij automjeti) ka paguar shumën e rënë dakord për blerje dhe ka marrë automjetin që në muajin prill 2014 (fundi i muajit). Për arsye objektive të të dyja palëve (shitësit J dhe blerësit A) kontrata nuk u mundësua të përpilohej në momentin e bërjes së pagesës dhe dorëzimit të sendit, por u realizua rreth një muaj e pak me vonesë dhe, konkretisht, në datën 18.6.2014.*

*Kam paraqitur deklaratën noteriale me nr. \*\*\*, të datës 20.9.2021, të nënshkruar nga A.M (blerësi i automjetit tip ‘\*\*\*’), ku ndër të tjera ai ka deklaruar se: ‘Unë deklaruesi A.M deklaroj se në muajin prill 2014, kam kontaktuar me z. J.Ll i cili kishte nxjerrë njoftimin për shitjen e një autoveture ‘\*\*\*’. Pas bisedimeve ne ramë dakord për blerjen e kësaj autoveture në shumën 5,000 euro shumë e cila është paguar nga ana ime cash dorazi në muajin prill 2014 dhe autovetura më është dorëzuar mua po në këtë muaj nga ana e z. J.Ll. Për shkak të disa problemeve të mia, si dhe arsye objektive të J kontrata është mundur të realizohet një muaj e ca me vonesë.*

*Në lidhje me pasaktësitë e konstatuar në deklaratimet që kam bërë për vlerën e automjetit tip \*\*\*, ashtu siç e kam shpjeguar edhe në pyetësorin nr. 3, ku kam shpjeguar se në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2011, e cila ka qenë deklarata e parë e plotësuar nga unë si subjekt, kam shënuar si vlerë blerjeje të këtij automjeti vlerën prej 500,000 lekësh. Ky shënim përbën gabim material nga ana ime, pasi gabimisht kam referuar në një transaksion tjetër për blerje automjeti që bashkëshorti im ka pasur më përpara për një automjet të ngjashëm me këtë që ka qenë po i llojit ‘\*\*\*’ me të njëjtën ngjyrë dhe i vetmi dallim ka qenë nr. i shasisë që unë nuk jam treguar e vëmendshme.*

*Në lidhje me pagesën që është kryer prej J.Ll për zhdoganimin e automjetit të tipit ‘\*\*\*’, ajo rezulton se është kryer në datën 21.12.2010, në vlerën 465,000 lekë. Në vitin 2010 nuk kam qenë subjekt për të deklaruar shpenzimet pranë ILDKPKI-së dhe si e tillë nuk është deklaruar një shpenzim i tillë.*

*Nuk kemi pasur informacion as unë as bashkëshorti im, që si vlerë e këtij automjeti duhej të konsiderohej edhe shpenzimi që është bërë për pagimin e vlerës së zhdoganimit. Këtë të fundit e kemi konsideruar gjithmonë si shpenzim që për aq kohë sa është kryer në vitin 2010, ku unë dhe bashkëshorti im nuk kemi plotësuar deklarata atëherë nuk kemi pasur se ku ta deklarojmë si shpenzim. Ndërkohë në momentin kur ky automjet do të shitej patjetër që është marrë në konsideratë në përcaktimin e çmimit të shitjes, edhe shpenzimet e kryera për atë automjet që efektivisht më pas rrisin edhe vlerën e automjetit”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**3.25** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti argumente dhe sqaroi se mosrakordimi i datës së shitjes së automjetit tip “\*\*\*\*” me datën e blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” (rreth një muaj më vonë) ka ndodhur për arsye objektive të shitësit e blerësit.

**3.26** Komisioni i konsideroi bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me vlerën e blerjes së pasurisë dhe burimin e saj, pavarësisht mosrakordimit të datës së shitjes me datën e blerjes, ku rezultoi se subjekti kishte pasur mundësi financiare dhe burime të ligjshme.

**3.27** Gjithashtu, mosdeklarimin nga bashkëshorti i subjektit, në DPV-në e vitit 2011, të vlerës së saktë të blerjes së automjetit në vitin 2009 (deklaruar në vlerën 500,000 lekë kundrejt vlerës së shpenzuar gjithsej prej 765,000 lekësh), Komisioni nuk e konsideroi si problematikë që ndikon në vendimmarrjen e tij.

**3.28** Rezultoi se subjekti e ka deklaruar saktë vlerën e blerjes së kësaj pasurie automjet tip “\*\*\*\*”, si dhe burimin e saj në deklaratën *Vetting*.

#### **4. Kursime gjendje cash**

**4.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* për herë të parë në DPV-në e vitit 2014, në vlerën 800,000 lekë.

**4.2** Në DPV-në e vitit 2015 (gjendje më 31.12.2015) subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën 500,000 lekë.

**4.3** Në DPV-në e vitit 2016 (gjendje më 31.12.2016) subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën 1,300,000 lekë.

**4.4** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar shumën 1,400,000 lekë dhe kjo deklaratë është plotësuar prej saj në janar të vitit 2017.

**4.5** Për mundësitë financiare për krijimin e këtyre kursimeve *cash* për vitet 2014 – 2016, shihni tabelën në analizën financiare më poshtë.

#### **5. Person fizik “J. Ll”**

**5.1** Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka aktivitet tregtar me NIPT \*\*\*, me objekt të veprimtarisë “farmaci, import-eksport dhe tregtim të produkteve kozmetike dhe sekondare farmaceutike, bar-kafe”.

**5.2** Ekstrakt historik për shtetasin J.Ll, person fizik me NIPT \*\*\*, datë regjistrimi 22.10.2012, me objekt “farmaci, import-eksport dhe tregtim i produkteve kozmetike dhe sekondare farmaceutike, bar-kafe”.

**5.3** QKB-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2017 konfirmon se shtetasi J.Ll është i regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\*. Bashkëlidhur ekstrakt historik për shtetasin J.Ll person fizik me NIPT \*\*\*, datë regjistrimi 22.10.2012, me objekt “farmaci, import-eksport dhe tregtim i produkteve kozmetike dhe sekondare farmaceutike, bar-kafe”.

**5.4** Sipas fakteve të njohura botërisht rezulton se bashkëshorti i subjektit, z. J.Ll, është arrestuar dhe ndjekur penalisht për kryerjen e veprës penale për ushtrim kontrabande me medikamente dhe hetim për pasurinë.

**5.5** Lidhur me këtë situatë, subjektit iu kërkua të japë shpjegime për këto fakte të konstatuara nga Komisioni, si dhe për ecurinë e procedimit penal të ushtruar ndaj bashkëshortit të saj.

**5.6** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: “Në datën 13.6.2018 bashkëshorti im J.Ll, në ambientet ku ai ushtronte aktivitetin tregtar është arrestuar si i dyshuar për kryerjen e veprave penale ‘tregtim dhe transportim i mallrave që janë kontrabandë’, ‘fshehje e të ardhurave’ dhe ‘shkelje e të drejtave të pronësisë industriale’, të parashikuara nga nenet 149/a, 178 dhe 180 të Kodit Penal. Mënyra e publikimit të këtij lajmi nga disa media nuk ka qenë korrekte sepse kanë transmetuar pamje vizive të arrestimit të një personi tjetër. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar masën e sigurimit ‘detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore’. Pas përfundimit të hetimeve, prokurori

*i çështjes i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018, për veprat penale të sipërcituara. Gjykata, nga ana e saj me vendimin e datës 6.2.2019 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018, për veprat penale ‘transportim dhe tregtim i mallrave që janë kontrabandë’ dhe ‘fshehja e të ardhurave’, të parashikuara nga nenet 178 dhe 180 të Kodit Penal. Ky vendim nuk është ankimuar. Pasqyrat financiare tregojnë se personi fizik ‘J.Ll’ vetëm në vitin 2017 ka deklaruar shumën prej 10,667,951 dhe ka paguar tatimin mbi të ardhurat për këtë vlerë fitimi dhe asnjëherë ndaj tij nuk është bërë hetim pasuror”.*

**5.7** Deklarimet e subjektit lidhur me procedimet penale dhe përfundimet e tyre janë provuar edhe nga praktika e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>2</sup>.

**5.8** Pyetjes nëse ka përfitur bashkëshorti fonde publike nga ndonjë insitucion shtetëror gjatë aktivitetit të tij tregtar, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje, ka deklaruar se: *“J.Ll gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij që nga viti 2012 dhe aktualisht nuk ka përfitur asnjëherë fonde publike nga asnjë institucion shtetëror dhe nuk ka qenë pjesëmarrës në procedura prokurimi në institucione shtetërore”.*

**5.9** DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2017, konfirmon se shtetasi J.I.Ll është i regjistruar në organin tatimor më 22.10.2012 me NIPT \*\*\*, me administrator J.Ll me status ligjor “person fizik” me status “aktiv”, me aktivitet “farmaci, import-eksport dhe tregtim i produkteve kozmetike dhe sekondare farmaceutike dhe bar-kafe” në rrugët “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*” me përgjegjësi tatimore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, tatim i mbajtur në burim, tatim mbi fitimin dhe TVSH-në. Nga data e regjistrimit dhe në vazhdim subjekti është deklarues në organet tatimore dhe nuk ka deklarata të padërguara. Nga verifikimi i pasqyrave financiare rezultojnë këto të dhëna:

Viti	Të ardhura/lekë	Shpenzime/lekë	Fitimi/lekë
2012	371.018	381.620	-10.602 (humbje)
2013	3.783.131	3.478.038	305.093
2014	6.291.304	5.780.689	510.615
2015	20.830.294	18.451.479	2.378.815
2016	43.665.346	39.217.517	4.447.829

**5.10** Subjekti nuk ndan dividend, pasi bazuar në nenin 33/1 “Vendimi për destinimin e fitimit” tatimi mbi të ardhurat, i ndryshuar, subjekti person fizik ka detyrim të depozitojë pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës, por nuk ka detyrim shpërndarjen e dividendit.

**5.11** Bashkia Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2017, konfirmon se shtetasi J.I.Ll është i regjistruar në programin informatik me NIPT \*\*\* si person fizik, lloji i biznesit “biznes i madh” me tri njësi si vijon: Njësia Nr.\*\*\* për aktivitetin “farmaci” në rrugën “\*\*\*\*”, përballë spitalit pediatrik me status “aktiv”, data e licencimit 22.10.2012, Njësia Nr. \*\*\* për aktivitetin “farmaci” në “\*\*\*\*”, objekt me nr. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, me status “aplikim për çregjistrim”, datë 6.3.2017, Njësia Nr. \*\*\*, për aktivitetin “bar - kafe”, në adresën: rruga “\*\*\*\*”, p. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, me status “aktiv”, data e licensimit 10.1.2017.

<sup>2</sup>Shihni përgjigjen e Prokurorisë dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.6.2021.

**5.12** Në DPV-në e vitit 2012 subjekti deklaroi aktivitet privat person fizik, fusha e veprimtarisë farmaci, i pajisur me NIPT dhe datë regjistrimi 22.10.2012. Vlera e investimit fillestar: 1,500,000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat personale të gjeneruara nga puna.

**5.13** Analiza e mundësisë së investimit në biznes datë 22.10.2012

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura Matilda Llangozi 1.1.2012 – 22.10.2012	671,294
Të ardhura J. Ll (QSUT) 1.1.2012 – 22.10.2012	375,758
Të ardhura J.Ll (H lekë) 1.1.2012 – 22.10.2012	1,348,396
Të ardhura J.Ll (H euro) 1.1.2012 – 22.10.2012	935,845
<b>Të ardhura totale 1.1.2012 – 22.10.2012</b>	<b>3,331,293</b>
Shpenzime jetese 1.1.2012 – 22.10.2012	465,160
Shpenzime udhëtimi 1.1.2012 – 22.10.2012	53,636
Investim në aktivitet privat - 22.10.2012	1,500,000
<b>Shpenzime totale 1.1.2015 – 10.7.2015</b>	<b>2,018,796</b>
<b>Ndryshimi në likuiditete 31.12.2014 – 10.7.2015</b>	<b>151,859</b>
<b>Mundësia financiare</b>	<b>1,160,639</b>

**5.14** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur burime të mjaftueshme për investimin në aktivitetin privat, përballimin e shpenzimeve dhe shtimin e likuiditeteve deri në datën e regjistrimit të biznesit.

**5.15** Në përfundim të rezultateve të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me personin fizik “J.Ll”. Të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore janë llogaritur në analizën financiare më poshtë në vendim.

## **KONSTATIME TË TJERA**

### **6. Ushtrimi i aktivitetit si person fizik nga subjekti në vitet 2008 - 2009**

**6.1** Subjekti ka rezultuar të jetë regjistruar si person fizik me fushë veprimtarie “studio ligjore” në vitin 20.5.2008. Rezulton pranë QKB-së se statusi aktual për këtë aktivitet privat është “aktiv”. Për këtë arsye subjekti u pyet që të japë shpjegime se përse nuk janë ndjekur procedurat ligjore për çregjistrimin si person fizik pranë QKB-së të aktivitetit privat, nga momenti i fillimit të ushtrimit të funksionit si magjistrat.

**6.2** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: “Përgjatë viteve 2008 deri në vitin 2009 kam ushtruar profesionin e avokates me nr. NIPTI \*\*\*, duke shlyer detyrimet pranë Dhomës së Avokatisë dhe Bashkisë Tiranë. Në vitin 2009 kam filluar studimet për magjistraturë. Kam vënë në dijeni dhomën e avokatisë dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2021, të kryetarit të DHKA, ndër të tjera, thuhet se: ‘Ka ushtruar profesionin e avokatit në vitet 2008 - 2009. Për vitin 2010 e në vijim figuron në regjistrin e avokatëve pasiv për shkak të papajtueshmërisë ligjore. Me kryerjen e kësaj procedure kam menduar se nuk është e nevojshme kryerja e ndonjë veprimi tjetër. E që prej asaj kohe e deri tani nuk kam ushtruar asnjë veprimtari të kësaj natyre. Me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 25.6.2020, të nxjerrë nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve rezultoi se për periudhën 2008 – 2011 kam qenë me status ‘aktiv’, ndërsa që në vitin 2011 kam kaluar me status ‘pasiv’, kjo për shkak të mosdepozitimit të deklaratave tatimore për një periudhë 2-vjeçare. Nuk jam vënë në dijeni asnjëherë nga Drejtoria e Tatimeve për procedurat që unë duhet të kryeja për çregjistrimin e aktivitetit tregtar që unë kam pasur”.

**6.3** Nuk rezultoi se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatisë pas vitit 2009, periudhë kur ka filluar Shkollën e Magjistraturës, apo të ketë deklaruar dhe përfituar të ardhura për këtë periudhë.

## **7. Lidhur me adresat e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike**

**7.1** Komisioni konstatoi se subjekti, në deklaratat periodike vjetore, ka deklaruar si adresë të gjendjes civile: Njësia Administrative Nr. \*\*\* rruga “\*\*\*”, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Lidhur me këtë konstatim, subjekti u pyet që të deklarojë kujt i përket kjo pasuri, lidhjen e subjektit me pasurinë dhe pronarët dhe periudhën e përfutimit të kësaj pasurie.

**7.2** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të tretë, deklaroi se: *“Pasuria e sipërcituar është në pronësi të babait të bashkëshortit tim, z. B.Ll (vjehtëri im). Kjo pasuri është poseduar nga familja e bashkëshortit tim që prej vitit 2004, pasi në datën 8.6.2004 ndërmjet palëve shoqëria ‘\*\*\*’ dhe B. Ll është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes. Bashkëngjitur po ju paraqes një kopje të kontratës së shitblerjes së pasurisë ku në nenin 2 pika 2.2. parashikohet edhe data e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes ndërmjet të njëjtave palë dhe, konkretisht, kontrata nr. \*\*\* rep., datë 8.6.2004. Në datën 25.11.2004, bashkëshorti im J.Ll ka transferuar gjendjen civile nga zyra e Gjendjes Civile Kuçovë në Zyrën e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. \*\*\* Tiranë, duke deklaruar si adresë banimi rruga ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, që ishte apartamenti në posedim të babait të tij B.Ll. Bashkëngjitur po ju paraqes certifikatën e përbërjes familjare me kryefamiljar J.Ll, të lëshuar në datën 15.9.2021 nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. \*\*\* Tiranë, në bazë të së cilës provohet momenti i regjistrimit të J në Tiranë.*

*Në muajin dhjetor 2006 unë jam martuar me z. J.Ll dhe në kushtet kur ai vijonte të ishte i regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. \*\*\* Tiranë atëherë edhe unë si bashkëshortja e tij u regjistrua në këtë adresë. Bashkëngjitur po ju paraqes certifikatën e përbërjes familjare për familjen me kryefamiljar J.Ll të lëshuar në datën 15.9.2021 nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. \*\*\* Tiranë dhe që pasqyron përbërjen familjare të datës 1.1.2007.*

*Theksoj se asnjëherë nuk kam banuar në banesën e vjehtërit tim B.Ll me përjashtim të vizitave ditore ose disa ditore si e fejuara e djalit të tij.*

*Që prej fundit të vitit 2007 deri në dhjetor 2014 unë kam banuar në apartamentin që ndodhet në adresën: blv. ‘\*\*\*’, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë. Ky fakt është deklaruar prej meje që në deklaratën e interesave private përpara fillimit të detyrës të datës 9.12.2011, si dhe në çdo deklaratë të interesave private periodike si adresë ku unë banoj, ndërsa si adresë ku unë rezultoj e regjistruar sipas gjendjes civile kam deklaruar: rruga ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë”.*

**7.3** Bazuar në përgjigjen e subjektit dhe provat e administruara, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me adresën e deklaruar nga subjekti si adresë të gjendjes civile. Pasuria apartament e deklaruar si adresë nga subjekti duket se është përfituar nga prindërit e bashkëshortit të subjektit para fillimit të detyrës së subjektit si gjyqtare. Nuk kanë lindur dyshime të mëtejshme për këtë pasuri.

**Konstatime të tjera në lidhje me indicie të mbërritura në Komision për subjektin e rivlerësimit Matilda Llangozi**

## **8. Lidhur me pasuritë e babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. B.Ll**

**8.1** Nga *indicie* të mbërritura në Komision pretendohet për pasuri të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në emër të babait.

**8.2** Nga verifikimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme pranë ASHK-së, ka rezultuar se babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit B.Ll ka në pronësi dy apartamente: një apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, Bashkia Kuçovë, regjistruar pranë ish-ZRPP-së, në datën 17.2.2005 dhe një apartament nr. \*\*\*, me sip. 101 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, regjistruar pranë ASHK-së, më 23.3.2016.

**8.3** Subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të paraqesë prova me dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të këtyre dy pasurive të sipërcituara të babait të bashkëshortit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/ 2016.

### **Qëndrimi i subjektit**

**8.4** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi se: *“Përpara se të jap shpjegimet dhe informacionet për sa kërkohet, fillimisht doja t’ju shpjegoja se unë Matilda Llangozi jam martuar me shtetasin J.Ll në muajin dhjetor të vitit 2006. Në kohën kur unë jam martuar, prindërit e bashkëshortit tim B dhe B.Ll kanë pasur në pronësi një banesë në qytetin e Kuçovës dhe kanë qenë në posedim të një apartamenti në Tiranë, në bazë të kontratës së sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep., datë 8.6.2004.*

*Pasuria apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, rruga ‘\*\*\*’, Bashkia Kuçovë është fituar në bazë të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\*, të datës 10.10.1995, ku pala shitëse B, Sh e A.J, etj., i kanë shitur blerësve B dhe B.Ll pasurinë e ndodhur në lagjen ‘\*\*\*\*’ me nr. \*\*\*, kundrejt vlerës 1,000,000 lekë. Prindërit e bashkëshortit kanë ardhur në qytetin e Kuçovës në vitin 1995 nga fshati \*\*\* i rrethit Berat. Në këtë fshat ata kanë pasur në pronësi një shtëpi banimi njëkatëshe, të cilën e kanë shitur së bashku me oborrin në shumën prej 800,000 lekësh shtetasit F.Ll (nuk disponojnë dokumentacion në lidhje me këtë shitje, por kjo bazuar në deklaratimet që më kanë dhënë vetë prindërit e bashkëshortit). Të ardhurat nga shitja e banesës në \*\*\* së bashku dhe me vlerën prej 200,000 lekësh, që kanë qenë kursime të krijuara ndër vite nga puna e prindërve të bashkëshortit, ku babai i tij ka qenë doktor që prej vitit 1972 dhe nëna e tij ka qenë infermiere-mami që prej vitit 1971, kanë shërbyer për blerjen e banesës në Kuçovë.*

*Në bazë të kontratës së sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep., datë 8.6.2004, prindërit e bashkëshortit tim janë vënë në posedim të apartamentit nr. \*\*\*, me sip. 101 m<sup>2</sup>, rruga ‘\*\*\*\*’, Tiranë. Për shkak të problematikave në kolaudimin e punimeve të pallatit, si dhe pajisja me dokumentacionin përkatës në bazë të legjislacionit, pala sipërmarrëse shoqëria ndërtuese ka realizuar kontratën e shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme në datën 18.3.2016 me nr. \*\*\*. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet shoqërisë ‘\*\*\*\*’ dhe shtetasit B.Ll. Në këtë kontratë në pikën 2.2 është parashikuar se: ‘Kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit jashtë kësaj zyre, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 8.6.2004. Pra, pagesa për blerjen e këtij apartamenti është bërë që në vitin 2004 rreth dy vite përpara se unë të martohesha me shtetasin J.Ll. Bashkëngjitur po ju paraqes: kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\*, të datës 10.10.1995 (për pasurinë në Kuçovë); kontrata e shitjes me nr.\*\*\*, të datës 18.3.2016 është dorëzuar nga ana ime bashkëngjitur pyetësorit nr. 3, si dhe librezat e punës së B.Ll e B.Ll”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**8.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti argumente dhe prova për pasurinë apartament me sip. 79 m<sup>2</sup>, Bashkia Kuçovë, e cila rezulton se është fituar në bazë të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të vitit 1995, kundrejt vlerës 1,000,000 lekë. Prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë shitur në \*\*\*, Berat, një shtëpi banimi njëkatëshe në shumën

800,000 lekë. Të ardhurat nga shitja e banesës në \*\*\*, së bashku edhe me vlerën 200,000 lekësh, që kanë qenë kursime të krijuara ndër vite nga prindërit (babai i tij ka qenë doktor që prej vitit 1972 dhe nëna e tij ka qenë infermiere – mami që prej vitit 1971), kanë shërbyer për blerjen e banesës në Kuçovë.

**8.6** Ndërsa për pasurinë apartament me sip. 101 m<sup>2</sup>, në blv. “\*\*\*\*”, Tiranë, rezulton se prindërit e bashkëshortit të subjektit janë vënë në posedim në bazë të kontratës së sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep., datë 8.6.2004, dhe kontratës së shitjes së kësaj pasurie në datën 18.3.2016, ku në pikën 2.2 të saj thuhet se: “Kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit jashtë kësaj zyre, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 8.6.2004”. Pra, pagesa për blerjen e këtij apartamenti është bërë që në vitin 2004, dy vite përpara martesës së subjektit me bashkëshortin J.Ll. Të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2004, kanë qenë kursimet nga puna ndër vite e prindërve të bashkëshortit për periudhën 1995 – 2004, si dhe të ardhurat e realizuara nga djali tjetër i tyre G.Ll.

**8.7** Sa më sipër, referuar argumenteve dhe provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konkludoi në përfundimin se pasuritë e prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit janë pasuri të tyre të krijuara para martesës së subjektit dhe para fillimit të ushtrimit të detyrës si gjyqtare. Pra, nuk ka dyshime që ato janë pasuri të subjektit të rivlerësimit.

## **9. Në lidhje me pronësinë e dy qiradhënësve të objekteve, ku ushtron aktivitetin tregtar bashkëshorti J.Ll**

**9.1** Nga *indicie* të ardhura në Komision pretendohet për pronësinë e dy farmacive në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**9.2** Bashkëshorti J.I.Ll, në cilësinë e administratorit me status ligjor “person fizik” me status “aktiv”, ushtron aktivitet tregtar “farmaci, import - eksport dhe tregtim i produkteve kozmetike dhe sekondare farmaceutike dhe bar-kafe”, në dy objekte me adresë përkatësisht: rruga “\*\*\*\*” dhe rruga “\*\*\*\*”, Tiranë.

**9.3** Për këtë arsye, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime dhe prova me dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë të qiradhënësve të këtyre dy objekteve, kopje të kontratave të qiramarrjes, mënyrën e pagesës së qirave mujore dhe vërtetimin nëse janë paguar detyrimet tatimore pranë organeve ekzekutive, në të cilat ushtron aktivitetin tregtar bashkëshorti, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit**

**9.4** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi se: “Në bazë të kontratës së qirasë me nr. \*\*\*, të datës 29.10.2013, rezulton se shtetasi Z.Xh, me cilësinë e pronarit të pasurisë së paluajtshme të llojit apartament me sip. 60.03 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, në rrugën ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, i jep me qira qiramarrësit J.Ll ambientin e mësipërm kundrejt pagesës së qirasë në vlerën 20,000 lekë/muaj. Kjo kontratë është nënshkruar për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë rinovimi.

*Pronësia e shtetasit Z.Xh mbi këtë pasuri provohet në bazë të certifikatës për vërtetim pronësie datë 7.8.2006 (e dhënë kjo e shënuar nga noterja në kontratën e sipërcituar). Ndërkohë rezulton se shtetasi Z.Xh e ka blerë këtë pasuri në bazë të kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, të datës 27.11.1997, nga palët shitëse B dhe G.G..*

*Në datën 22.5.2015 ka vdekur shtetasi Z.Xh. Në bazë të dëshmisë së trashëgimisë testamentare me nr. \*\*\*, të datës 15.2.2016, rezulton se është vendosur: ‘Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë*



testamentare për të ndjerin Z. Xh duke përcaktuar si trashëgimtare testamentare bashkëshorten e tij, të quajturën L.Xh, në pasurinë e paluajtshme të llojit 'apartament' me nr. pasurie \*\*\* z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f.\*\*\*, rruga '\*\*\*'. Pas kësaj, pranë ZVRPP-së Tiranë është bërë kalimi i pasurisë përkatëse në emër të L.Xh. Disa muaj përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën e qirasë (afati 5-vjeçar), në datën 26.2.2018 është nënshkruar kontrata e qirasë me nr. \*\*\*, midis palëve L. Xh dhe J.Ll për të njëjtin ambient.

Sa më sipër, rezulton që pasuria ku ushtron aktivitetin bashkëshorti im, që ndodhet në adresën rruga '\*\*\*', ka qenë që prej vitit 7.8.2006 në pronësi të bashkëshorteve Z dhe L.Xh, të cilët nuk rezultojnë të kenë ndonjë lidhje familjare apo shoqërore me bashkëshortin tim, përveçse lidhjeve që, burojnë nga kontrata e qirasë, të nënshkruara ndërmjet palëve.

Qiraja është paguar cash çdo fillim muaji dhe kjo pagesë është pasqyruar në bilancet vjetore të aktivitetit tregtar të çdo viti si shpenzim. Deri në këto momente, midis palëve nuk ka pasur asnjëherë mosmarrëveshje në lidhje me pagesën e qirasë mujore.

Gjithashtu rezulton që për këtë pasuri është paguar edhe tatimi në burim nëpërmjet bankës dhe që provohet nga dokumentet bashkëngjitur, të lëshuara nga organet tatimore. Bashkëngjitur provat shkresore: kontrata e qirasë me nr. \*\*\*, të datës 29.10.2013, të lidhur midis Z.Xh dhe J.Ll; kontrata e qirasë me nr. \*\*\*, të datës 26.2.2018, të lidhur ndërmjet L.Xh dhe J.Ll; dëshmia e trashëgimisë testamentare me nr. \*\*\*, të datës 15.2.2016 për trashëgimlënësin Z.Xh; certifikata për vërtetim pronësie e datës 7.8.2006; kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\*, të datës 27.11.1997 dhe të dhëna nga organet tatimore për pagesën e tatimit në burim për objektin e marrë me qira.

Ndërsa për pasurinë e ndodhur në rrugën '\*\*\*', Tiranë, ku bashkëshorti im ka ushtruar aktivitetin bar-kafe, në bazë të kontratës së qirasë me nr. \*\*\*, të datës 21.10.2016, rezulton se shtetasi P.M me cilësinë e pronarit të pasurisë së paluajtshme të llojit apartament me sip. 71.3 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Tiranë, në rrugën '\*\*\*', godina \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\* (pronësia e provuar nga noterja në bazë të certifikatës për vërtetim pronësie datë 28.10.2013), ka dhënë me qira këtë ambient shtetasit J.Ll. Në këtë kontratë është përcaktuar si qira vlera prej 35,000 lekësh dhe është nënshkruar për një afat prej 5-vjeçar. Kjo qira është paguar çdo muaj cash nga ana e J.Ll. Pagesa e kësaj qiraje është pasqyruar në bilancet vjetore të subjektit person fizik J.Ll.

Në datën 29.12.2018 bashkëshorti im J.Ll vendos të shesë aktivitetin tregtar bar-kafe të regjistruar me nipt sekondar. Kjo shitje aktiviteti është pasqyruar në faturën tatimore të shitjes me nr \*\*\*, datë 29.12.2018, me nr. serial \*\*\*, si dhe në bilancin vjetor të subjektit person fizik J.Ll për vitin 2018.

Në kushtet kur aktiviteti u shit, në datën 3.1.2019 nga ana e P.M dhe J.Ll është nënshkruar deklarata noteriale me nr. \*\*\*, të datës 3.1.2019. Në bazë të kësaj deklarate rezulton se palët kanë rënë dakord që palët të revokojnë kontratën e qirasë së lidhur ndërmjet tyre në datën 21.10.2016 duke qenë se pala qiramarrëse ia ka shitur biznesin një pale tjetër. Në këtë deklaratë pranohet që marrëdhëniet kontraktore me njëri-tjetrin kanë përfunduar dhe ata nuk kanë detyrime ndaj njëri-tjetrit.

Përparim Myftiu e ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri në bazë të kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, të datës 19.6.1998, ku ai si blerës ia ka blerë pasurinë të llojit "apartament" me sip. 71.3 m<sup>2</sup> e ndodhur në adresën: rruga '\*\*\*', p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, shitësit Q dhe B.K.

Edhe për këtë objekt janë paguar tatimi në burim nga ana e subjektit person fizik J.Ll nëpërmjet bankës, të cilat janë të reflektuara në bilancet përkatëse. Bashkëngjitur po ju paraqes si prova shkresore:

*Kontrata e qirasë me nr. \*\*\*, datë 21.10.2016, e nënshkruar ndërmjet P.M dhe J.Ll; fatura tatimore e shitjes me nr. \*\*\*, datë 29.12.2018 për shitjen e aktivitetit bar-kafe; deklarata noteriale për revokim kontrate qiraje me nr. \*\*\*, të datës 3.1.2019 dhe kontrata e shitjes me nr. \*\*\*, të datës 19.6.1998, e nënshkruar midis shitësit Q.K dhe P. M.*

*Sa më sipër shpjegova, rezulton se bashkëshortin tim nuk e lidh asnjë veprim juridik apo ndonjë situatë që mund të lindë dyshimi se pasuritë që ai përdor për ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar, në bazë të kontratave të qirave përkatëse, të jenë pasuri të fshehura prej tij”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

**9.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti argumente dhe prova të mjaftueshme që vërtetojnë pronësinë e qiradhënësve të objekteve, në adresat e sipërshënuara, ku ushtron aktivitetin e tij tregtar bashkëshorti i subjektit J.Ll. Për këtë arsye, nga Komisioni nuk rezultoi asnjë dyshim mbi pronësinë e dy objekteve ku ushtrohej aktiviteti, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

## **10. Në lidhje me analizimin e shlyerjes së kredisë më 10.3.2017**

**10.1** Nga analizimi i deklaratës *Vetting* të vitit 2017, rezultoi se subjekti ka deklaruar kursime gjendje *cash* në datën 26.1.2017, shumën 1,400,000 lekë dhe kontratë kredie afatgjatë me vlerë të mbetur 6,548,053,49 lekë debi deri në datën 27.1.2017 dhe personi i lidhur ka të njëjtin deklaram.

**10.2** Më tej, në deklaratën vjetore të vitit 2017, në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” deklaroi se: “*Debia totale është shlyer në datën 10.3.2017 për shumën 6,840,359 lekë*”, pa deklaruar burimin e shlyerjes së kësaj kredie.

**10.3** Subjekti, në pyetësonin standard, ku është pyetur lidhur me shpenzimet mbi vlerën 2,000 euro, ndër shpenzimet e tjera, deklaroi si vijon: “*Datë 10.3.2017. Shlyerje totale e kredisë së marrë pranë bankës ‘Societe General Albania’, më 4.12.2014. Në datën 10.3.2017 është paguar vlera prej 6,800,000 lekë me qëllim mbylljen totale të kredisë. Debia totale është shlyer në datën 10.3.2017 dhe është mbyllur me deklaratë noteriale për lirim hipotekë me nr. \*\*\*, të datës 8.6.2017 pranë noterit publik O.D. Burimet financiare që janë përdorur për këtë shlyerje janë nga të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, ku në këtë periudhë ka bërë shitje të një pjese të aktivitetit të tij tregtar”.*

**10.4** Nga analizimi i deklarimeve, Komisioni konstatoi se:

- Mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të ardhurat nga biznesi që kanë shërbyer si burim për shlyerjen e menjëhershme të kredisë.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit deri më 27.1.2017.

**10.5** Për sa më sipër, në lidhje me rezultatet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë shpjegime, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

## **Qëndrimi i subjektit**

**10.6** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, sqaroi se: “*Në datën 4.12.2014 unë së bashku me bashkëshortin tim J.Ll kemi nënshkruar kontratën e kredisë bankare ku subjekti kredihënës banka ‘Societe Generale Albania’ do të lëvrojë kredinë në vlerën 7,000,000. Afati i kësaj kredie është 20 vjet me interes 4.9% dhe numri i kësteve është 240 sipas pasqyrës përmbledhëse të pagesave, bashkëngjitur kontratës përkatëse. Në datën 10.3.2017 nga ana e bashkëshortit J.Ll është kryer pagesa e vlerës totale të detyrimit të mbetur të kësaj kredie, si*

dhe penaliteti përkatës për shlyerje të kredisë para kohe. Shifra që është shlyer në këtë datë është në masën 6,800,000 lekë. Sqarohet se burimi i kësaj pagese ka qenë shitja që ka bërë bashkëshorti im i një aktiviteti (farmaci e pajisur me nipt sekondar) shtetasit A.K. Ky veprim është pasqyruar në faturën tatimore të shitjes me nr. \*\*\*, datë 28.2.2017 dhe kalimi i kësaj shume është bërë nëpërmjet bankës 'Societe Generale Albania' në datën 8.3.2017. Gjithashtu, ky veprim tregtar është pasqyruar edhe në bilancin vjetor të personit fizik me NIPT \*\*\* (J.Ll). Pas kalimit të kësaj shume në datën 8.3.2017, bashkëshorti J. Ll ka bërë kalimin në llogarinë bankare për shlyerje kredie në datën 10.3.2017.

Në datën 13.3.2017 është pasqyruar kalimi i kësaj shume për pagesë kësti, si dhe komisione për pagesën para afatit të kredisë. Të gjitha këto veprime janë bërë nëpërmjet bankës 'Societe Generale Albania'. Pas shlyerjes së kredisë para afatit të përcaktuar në datën 8.6.2017 është nënshkruar deklarata noteriale për lirim hipoteke me nr. \*\*\*. Këtë deklaratë noteriale e kanë nënshkruar Drejtori i Sektorit të Riskut të Kredisë dhe Drejtori i Departamentit të Bizneseve të Vogla dhe Profesioneve të Lira pranë bankës 'Societe Generale Albania'.

Në lidhje me konstatimin tuaj se nuk kam deklaruar të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit deri më 27.1.2017, jap sqarimin se bazuar në legjislacionin fiskal dhe tatimor bilancet e të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana e një subjekti realizohen vetëm pasi është mbyllur viti ekonomik përkatës dhe që në rastin konkret është nga data 1.1.2017 deri në 31.12.2017 dhe ky bilanc duhet të dorëzohet pranë organeve tatimore deri në datën 31.3.2018 (pra të vitit pasardhës). Pra, bilanci është vjetor dhe bazuar në vitin kalendarik të plotë. Për aktivitetin e bashkëshortit tim nuk dorëzohen bilance mujore.

Në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting nga ana ime më 27.1.2017 kam dhënë të dhëna për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti për vitin 2016, i cili ishte vit që ishte mbyllur nga ana ekonomike. Ndërsa për periudhën 1.1.2017 - 27.1.2017 kam qenë në pamundësi për të përcaktuar këto të ardhura në kohën kur edhe muaji nuk ishte mbyllur nga ana ekonomike. Këtë e vërtetoj nëpërmjet provave shkresore:

- faturë tatimore të shitjes me nr. serial \*\*\*, nr. fature \*\*\*, datë 28.2.2017;
- lëvizjet e llogarisë sipas kërkesës për klientin J.Ll (PF) për periudhën 1.1.2017 - 31.12.2017. Në këtë konfirmohet se në datën 8.3.2017 është kryer pagesa prej 6,780,000 lekësh si likuidim fature nr. \*\*\*, datë 28.2.2017;
- lëvizjet e llogarisë sipas kërkesës për klientin J.Ll ose M. Ll (llogaria bankare për kredinë e marrë) për periudhën 1.1.2017 - 31.12.2017;
- mandatpagesat e bëra për shlyerjen e kredisë përpara përfundimit të afatit të bëra në datat 10.3.2017 dhe 13.3.2017;
- deklarata noteriale për lirim hipoteke me nr. \*\*\*, të datës 8.6.2017”.

## **Vlerësimi i Komisionit**

**10.7** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se burimi i kësaj pagese ka qenë shitja që ka bërë bashkëshorti i saj të një aktiviteti (farmaci e pajisur me nipt sekondar) shtetasit A. K. Ky veprim është vërtetuar nga fatura tatimore e shitjes me nr. \*\*\*, datë 28.2.2017, me vlerë totale 6,780,000 lekë. Kalimi i kësaj shume është bërë nëpërmjet bankës “Societe Generale Albania” në datën 8.3.2017. Ky veprim tregtar është pasqyruar edhe në bilancin vjetor të personit fizik me NIPT \*\*\* (J.Ll).

**10.8** Pas kalimit të kësaj shume në datën 8.3.2017, bashkëshorti i subjektit ka bërë kalimin në llogarinë bankare për shlyerje kredie në datën 10.3.2017. Në datën 13.3.2017 është pasqyruar kalimi i kësaj shume për pagesë kësti, si dhe komisione për pagesën para afatit të kredisë. Të gjitha këto veprime janë bërë nëpërmjet bankës “Societe Generale Albania”.

**10.9** Sa më sipër, është vërtetuar mundësia e shlyerjes së menjëhershme të kredisë me dokumentacion ligjor justifikues.

## 11. Analiza financiare

PËRSHKRIMI	10.11.2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>PASURI</b>	<b>-131,846</b>	<b>24,720</b>	<b>-47,357</b>	<b>8,451,455</b>	<b>639,608</b>	<b>971,676</b>	<b>9,908,256</b>
Apartament 79 m <sup>2</sup> rr. “***”, Tiranë - 30,000 euro				-3,900,000			<b>-3,900,000</b>
Apartament 136.1 m <sup>2</sup> , rr. “***”, Tiranë - 10,900,000 lekë - 2014				10,900,000			<b>10,900,000</b>
Tokë arë 1,500 m <sup>2</sup> ***, Tiranë - 649,500 lekë - 2015					649,500		<b>649,500</b>
Autoveturë “***” AA***JB - 5,000 euro - 2014				700,550			<b>700,550</b>
<b>Ndryshim në likuiditet</b>	<b>-131,846</b>	<b>24,720</b>	<b>-47,357</b>	<b>750,905</b>	<b>-9,892</b>	<b>971,676</b>	<b>1,558,206</b>

<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7,000,000</b>	<b>-211,481</b>	<b>-221,993</b>	<b>6,566,525</b>
Kredi S. G. - 7,000,000 lekë - 2014				7,000,000	-211,481	-221,993	<b>6,566,525</b>

<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>-131,846</b>	<b>24,720</b>	<b>-47,357</b>	<b>1,451,455</b>	<b>851,090</b>	<b>1,193,669</b>	<b>3,341,730</b>
--	-----------------	---------------	----------------	------------------	----------------	------------------	------------------

<b>TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>182,598</b>	<b>3,508,510</b>	<b>1,790,333</b>	<b>2,787,438</b>	<b>3,415,888</b>	<b>5,652,979</b>	<b>17,337,745</b>
Të ardhura nga puna, subjekti Matilda Llangozi	120,821	783,866	807,290	1,103,629	1,053,390	1,060,704	<b>4,929,700</b>
Të ardhura nga puna, bashkëshorti i subjektit J.Ll	44,492	2,724,644	983,043	983,259	2,362,498	3,780,655	<b>10,878,591</b>
Të ardhura nga shitja e automjetit *** - 5,000 euro - 2014				700,550			<b>700,550</b>
Të ardhura nga dhurimi G.Ll - 6,000 euro - 2016						811,620	<b>811,620</b>
Të ardhura nga interesat e depozitës në Credins Bank	17,285						<b>17,285</b>
<b>SHPENZIME</b>	<b>178,003</b>	<b>2,111,828</b>	<b>796,318</b>	<b>1,614,043</b>	<b>2,365,780</b>	<b>2,222,402</b>	<b>9,288,373</b>
Shpenzime jetese	51,233	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	<b>3,890,985</b>
Shpenzime interesi + sigurim + komisione kredie Societe General				55,173	370,358	359,808	<b>785,339</b>

Shpenzime arsimimi fëmijët			51,600	180,650	255,000	263,000	<b>750,250</b>
Shpenzime për elektroshtepiake					169,900		<b>169,900</b>
Shpenzim për investim në aktivitet privat - 2012		1,500,000					<b>1,500,000</b>
Shpenzim për automjetin ***				262,000			<b>262,000</b>
Shpenzime transporti Tiranë - Berat - Tiranë 2014 - 2016				200,000	200,000	200,000	<b>600,000</b>
Shpenzim për sigurim jete bashkëshorti i subjektit - 2015					140,403		<b>140,403</b>
Shpenzim për blerje fidanësh për tokën arë në *** - 2015					15,000		<b>15,000</b>
Shpenzime për blerje me kartë			57,268				<b>57,268</b>
Shpenzime udhëtimi	126,770	53,636	123,354	36,227	318,016	459,226	<b>1,117,228</b>

<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>136,441</b>	<b>1,371,962</b>	<b>1,041,372</b>	<b>-278,060</b>	<b>199,018</b>	<b>2,236,908</b>	<b>4,707,641</b>
				<b>Pamundësia financiare</b>			<b>-278,060</b>

**11.1** Në përfundim të hetimeve, Komisioni bazuar në analizën financiare rezultoi se, për periudhën 2011 – 2016, subjekti është në pamundësi financiare në shumën 278,060 lekë.

**11.2** Për sa më sipër, në lidhje me rezultatet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime dhe të paraqiste prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit**

**11.3** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se: *“Në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni jam tërësisht dakord dhe nuk kam kundërshtime as me rezultatet e tij dhe as me metodologjinë e përdorur. Ndërsa, në lidhje me rezultatin e kësaj analize ku, familja ime rezulton në një pamundësi financiare prej 278,000 lekësh, kjo shumë është relativisht e vogël për t’u marrë në konsideratë në raport me xhiron ditore dhe mujore që realizon bashkëshorti im si rezultat i aktivitetit të tij tregtar, çka e bën që të ketë gjithmonë likuiditete financiare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e domosdoshme të familjes në momentin që ato kryhen. Ashtu siç ka rezultuar edhe nga analiza juaj, bashkëshorti im ka realizuar një xhiro të përgjithshme, për periudhën 2012 – 2016 në vlerën rreth 740 milion lekë të vjetra. Kjo gjë do të thotë se familja ime gjithmonë ka pasur likuiditete monetare për të bërë shpenzimet e nevojshme në momentin kur ato janë bërë”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**11.4** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti prova bindëse për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, në lidhje me pamundësinë financiare në shumën 278,060 lekë.

**11.5** Komisioni, duke vlerësuar mënyrën e llogaritjes së të ardhurave vjetore të biznesit të bashkëshortit (trajtuar dhe në pikën 2.15 të këtij vendimi), nuk e konsideroi problematike pamundësinë financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit në vlerën totale prej 278,060 lekësh.

**11.6** Në përfundim të analizës financiare, Komisioni nuk e vlerësoi të rëndësishme pamundësinë financiare, duke arsyetuar dhe vlerësuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, gjatë marrjes së një vendimi përfundimtar për subjektin e rivlerësimit.

**11.7** Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e pasurive, ndryshimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve për të gjithë periudhën e ushtrimit të detyrës nga data 10.11.2011 deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*.

## **12. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare**

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare.

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të bankave të nivelit të dytë: Credins Bank, Raiffeisen Bank, ProCredit Bank, Tirana Bank, ABI Bank, OTP Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. (në vitet 2004 dhe 2007 - 2008), shoqërinë “\*\*\*\*” sh. a. (2006 – 2007), nga aktiviteti privat (2008), Shkollën e Magjistraturës (2009 – 2011), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2011 – 2014), si dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat (2014 – 2016).

- Subjekti pretendon të ardhura nga punësimi te “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën janar 2004 – tetor 2004, me pagë 50,000 lekë/muaj dhe për periudhën maj 2007 – janar 2008 me pagë 100,000 lekë/muaj.

• Subjekti sjell në përgjigje të pyetësorit nr. 2, librezë pune ku rezulton punësimi te “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën 5.1.2004 – 18.10.2004 dhe për periudhën 1.5.2007– 31.1.2008.

• Nga librezat e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore vërtetohet pagesa e kontributeve nga “\*\*\*\*” sh.a. për znj. M.M, për periudhën janar 2004 – gusht 2004, si dhe për periudhën maj 2007 – janar 2008.

• Nga vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2021, i ISSh-së, sjellë nga subjekti në përgjigje të po këtij pyetësori, vërtetohen të ardhurat, mbi bazën e të cilave janë derdhur kontributet nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën shkurt 2004 – tetor 2004 dhe për periudhën korrik 2007 – janar 2008. Për vitin 2004 paga *bruto* varion nga 10,400 lekë në 11,400 lekë/muaj dhe për vitet 2007 – 2008, paga *bruto* është 30,000 lekë/muaj.

Në analizën financiare të ardhurat e subjektit nga kjo shoqëri janë llogaritur bazuar në pagat *bruto* për të cilat janë paguar detyrimet tatimore të vërtetuara nga ISSh-ja.

- Gjithashtu, subjekti pretendon të ardhura nga punësimi te “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën tetor 2004 – prill 2007, me pagë fillestare 50,000 lekë/muaj dhe më pas gjatë vitit 2006 – 2007 me pagë 90,000 lekë/muaj.

• Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti paraqet një kontratë individuale pune të datës 15.10.2004 të lidhur mes punëdhënësit shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. dhe punëmarrësit M.M. Në kontratë thuhet se paga mujore do të jetë 50,000 lekë/ muaj.

• Subjekti sjell në përgjigje të pyetësorit nr. 2, librezë pune ku rezulton punësimi i saj te “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën 1.1.2006 – 30.4.2007.

• Nga librezat e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të sjella nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, vërtetohet pagesa e kontributeve nga “\*\*\*\*” sh.a. për M. M, për periudhën janar 2006 – prill 2006.

- Nga vërtetimi nr.\*\*\* prot., datë 23.6.2021, i ISSh-së sjellë nga subjekti në përgjigje të po këtij pyetësi, vërtetohen të ardhurat, mbi bazën e të cilave janë derdhur kontributet nga shoqëria “\*\*\*\* (\*\*\*)” sh.a., për periudhën janar 2006 – prill 2007. Për vitin 2006 paga *bruto* varion nga 12,600 lekë në 14,000 lekë/muaj dhe për vitin 2007, paga *bruto* varion nga 14,000 lekë në 26,000 lekë/muaj.

Në analizën financiare të ardhurat e subjektit nga kjo shoqëri janë llogaritur bazuar në pagat *bruto* për të cilat janë paguar detyrimet tatimore të vërtetuara nga ISSh-ja.

- Aktiviteti privat i subjektit

- Në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti sjell dokumentacion, lidhur me aktivitetin privat si avokate të ushtruar në periudhën 2008 – 2009.

- Me mandatarkëtimin nga Bashkia e Tiranës, vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore për biznesin nga subjekti M.M për këstin e dytë, të tretë dhe të katërt për vitin 2008.

- Për këtë vit, subjekti ka plotësuar një deklaratë parashikuese të qarkullimit vjetor, në të cilën qarkullimi i parashikuar për vitin 2008 ishte në vlerën 200,000 lekë. Duke zbatuar një marzh fitimi prej 80% mbi këtë xhiro, fitimi *neto* i llogaritur për këtë vit nga ky aktivitet, pasi është vërtetuar pagesa e detyrimeve tatimore, është në vlerën 160,000 lekë ( $200,000 \times 80\% = 160,000$ ).

- Për vitin 2009 nuk janë vërtetuar pagesat e detyrimeve tatimore. Si rrjedhim, në analizën financiare të vitit 2009, nuk janë përfshirë të ardhura nga ky aktivitet.

(ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit tek Qendra Spitalore Universitare “\*\*\*\*” (për periudhën 2007 – 2015), tek Spitali H (në vitin 2012), si dhe nga aktiviteti privat (për periudhën 2012 – 2016).

Në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti deklaron se bashkëshorti J.Lla, ka qenë i punësuar tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., gjatë gjithë vitit 2006. Subjekti paraqet një vërtetim të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., datë 9.12.2006, i cili vërteton punësimin e z. J.Ll pranë kësaj kompanie me pozicion menaxheri me pagë *neto* 70,000 lekë/muaj. Vërtetimi nuk cilëson periudhën e punësimit, si dhe nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të deklaruara. Për këtë arsye, deri në këtë moment, këto të ardhura nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);

ii) Shpenzime udhëtimi

Metodologjia për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit është bërë duke iu referuar vendimit nr. 11, datë 22.5.2019, për subjektin E. I., të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor, tek familjarët e subjektit/ bashkëshortit, nuk llogariten shpenzime qëndrimi. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

iii) Shpenzim takse për kalim pronësie të apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup> (në vitin 2007).

iv) Shpenzime interesash, principali dhe shpenzime të tjera të lidhura me kredinë në “Societe General Albania” (periudha 2014 – 2016).

v) Shpenzime për punime dhe mobilim të apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup> (2007 – 2011), sipas përgjigjes së pyetësorit nga subjekti. Disa nga këto shpenzime nuk kanë qenë të ndara sipas viteve. Shumica e tyre janë shpenzime të cilat janë të domosdoshme për ta bërë të banueshëm një apartament. Për këtë arsye, këto shpenzime janë përqendruar kryesisht në 2 vitet e para pas blerjes së apartamentit. Për vitin 2007 këto shpenzime janë vënë vetëm për vlerën e vërtetuar me faturë nga subjekti.

vi) Shpenzime për tarifë *titull avokat M. M* (viti 2008)

vii) Shpenzime arsimimi për fëmijët, sipas deklaramit të dhënë nga subjekti në përgjigje pyetësori dhe dokumenteve të sjella nga institucionet arsimore (2013 – 2016).

viii) Shpenzime për pajisje elektroshtëpiake në apartamentin me sip. 136 m<sup>2</sup> (2015).

ix) Shpenzimi për investim në aktivitetin privat “Farmaci”, nga bashkëshorti i subjektit J.LI (2012) deklaruar në DPV-në e vitit 2015.

x) Shpenzime për automjetin tip “\*\*\*\*” (2014) deklaruar dhe dokumentuar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

xi) Shpenzime transporti Tiranë-Berat-Tiranë për subjektin (2014 – 2016) deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

xii) Shpenzim për sigurim jete për bashkëshortin e subjektit (2015) sipas *statement* bankar nga “Raiffeisen Bank”.

xiii) Shpenzim për blerje fidanësh për tokën arë në \*\*\* (2015) deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

xiv) Shpenzime për blerje me kartë (2013).

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/ shitblerjeve të këtyre pasurive .

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK-ja në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenet 37 dhe 38, të ligjit 84 nr. 4/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2021, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. \*\*\*, datë 8.10.2021, të KDZh-së, ku rezulton se :

Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.

Për subjektin e rivlerësimit administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të korrupsionit pasiv për shkak të funksionit të saj, e konkretisht:

*Pas verifikimit të kryera nga autoritetet verifikuese është evidentuar se disponohen të dhëna ku për subjektin e rivlerësimit ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari korruptive, gjatë ushtrimit të detyrës.*



Për subjektin evidentohen rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm, sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në formën e një takimi të qëllimshëm në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Referuar informacioneve të marra nga institucionet verifikuese, subjekti i rivlerësimit rezulton individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të gërmës "c", të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, sipas përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit.

Për sa më sipër konstatohet se subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

### **Rivlerësimi i Komisionit**

Komisioni, bazuar në të dhënat e administruara dhe pas rivlerësimit të fakteve e rrethanave të cilat mund të çojnë në papërshtatshmërinë e subjektit, në referim të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, analizoi edhe njëherë faktet se, kur një subjekt konsiderohet se ka kryer një kontakt të papërshtatshëm, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi ose ndonjë marrëdhënie tjetër, nga ku rezultoi se në kuadrin e vlerësimit të figurës nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të këtë pasur ndonjëherë kontakt të papërshtatshme me persona të përfshirë në strukturat kriminale.

Nenin DH i Aneksit të Kushtetutës dhe me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kanë përcaktuar se:

*"1. Subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.*

*2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal.*

*3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.*

*4. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën."*

Referuar kësaj dispozite kushtuese, shkaqet për të cilat një subjekt rivlerësimi mund të shkarkohet, lidhet me katër (4) pikat e mësipërme.

Komisioni gjatë hetimit nuk konstatoj se subjekti i rivlerësimit të ishte në shkelje të këtyre kufizimeve ligjore. Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara

në deklaratën për kontrollin e figurës dhe se për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Pika 6, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka konsideruar se si “kontakt i papërshtatshëm”, është ai kontakt në formën e një takimi, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Nga dokumentacioni i administruar për kontrollin e figurës nuk provohet që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës.

Për sa i përket konceptit të personave të përfshirë në krimin e organizuar, Komisioni vlerëson se jepet në pikën 15 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kësaj dispozite me person të përfshirë në krimin e organizuar kuptohet çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: (a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; (b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

Komisioni në vlerësimin e figurës mbajti parasysh edhe vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>3</sup>.

Përfundimisht, Komisioni konstatoi se për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit apo kontakte të papërshtatshme.

Subjekti ka bërë deklaratime të sakta në formularin e deklarimit të figurës dhe nuk është përpjekur të fshehtë faktet apo kontakte, si dhe nuk është përpjekur të pasqyrojë në mënyrë të pasaktë rrethana të caktuara.

### **C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE**

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është përgatitur në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

<sup>3</sup>Shihni pikën 66 të vendimin nr. 1, datë 15.1.2020, të KPA-së.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës të ligjit, nuk ka mangësi apo kundërthënie dhe është nënshkruar në çdo fletë nga subjekti i rivlerësimit. Sipas të deklarimit të subjektit rezulton se gjyqtarja Matilda Llangozi, ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 28.6.2003. Për periudhën janar 2006 – janar 2008, ka qenë e punësuar menaxhere e burimeve njerëzore në shoqëri tregtare, nga shkurti 2008 – maj 2008 e papunë, nga maj 2008 – 2009 avokate, nga qershor 2009 – tetor 2009 e papunë, nga tetor 2009 – tetor 2012 studente në Shkollën e Magjistraturës, nga tetor 2012 – janar 2014 gjyqtare në pritje të emërimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga janari i vitit 2014 dhe aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Lidhur me ngarkesën sasiore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 1272 çështje dhe ka përfunduar 1193 çështje, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 76 çështje.

Të dhënat janë të dokumentuara në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2017, lëshuar nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Në këtë vërtetim shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- në vitin 2014, i janë caktuar 426 çështje, ka përfunduar 342 çështje;
- në vitin 2015, i janë caktuar 461 çështje, ka përfunduar 448 çështje;
- në vitin 2016, i janë caktuar 385 çështje, ka përfunduar 403 çështje.

Gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. Tri vendimet i përkasin një vendim vitit 2015 dhe dy vendime vitit 2016 (tri vendime civile).

- 1. Dokumenti 1:** vendimi nr. \*\*\*, datë 27.3.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me kërkues A.B, me objekt “parashkrimin e ekzekutimit të vendimit penal”.
- 2. Dokumenti 2:** vendimi nr. \*\*\*, datë 31.3.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me paditës Th. P, i paditur K.Ç, me objekt “ndëshkim moral dhe material për gjyqtarin, K.Ç”.
- 3. Dokumenti 3:** vendimi nr. \*\*\*, datë 19.11.2015, i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Berat, me paditës/i kundërpaditur T.M, paditës K.M etj., të paditur/kundërpaditës H.M, të paditur M.M etj., me objekt “detyrimin e të paditurve-trashëgimtar të S.M t’i njohin paditësit bashkëpronarë mbi pasurinë e paluajtshme”.

**Gjetjet nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv**

**Dosja 1.** Çështja penale nr. \*\*\* regjistri, datë 10.10.2014 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i pandehur R.L, akuzuar për kryerjen e veprës penale “drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.3.2015.

Me vendimin e datës 17.10.2014, gjyqtarja ka caktuar seancën e parë gjyqësore në datën 3.11.2014, ora 9:30, duke respektuar afatin 10-ditor të përcaktuar në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendim nr. \*\*\*, datë 18.1.2017, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 2.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari në datën 16.3.2015, 14 ditë pas nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 5 muaj e 10 ditë, në intervalin kohor 13.10.2014 – 2.3.2015, nga data e shortit. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9-mujor të përcaktuar nga pika 5, e germës “a”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit<sup>4</sup>. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar të përcaktuar nga pika 2, e neni 28 të Kushtetutës dhe pika 3, e neni 5 i KEDNj-së.

Vendimi që ka përfunduar çështjen përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

**Dosja 2.** Çështja penale nr. \*\*\* regjistri, datë 2.4.2014 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i pandehur A.D, akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, e mbetur në tentativë e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.5.2014.

Çështja është regjistruar në gjykatë dhe me shortin e datës 17.4.2014, ajo i është caktuar gjyqtarës Matilda Llangozi dhe në datën 21.4.2014 gjyqtarja vuri në lëvizje çështjen dhe caktoi seancën e parë në datën 8.5.2014, ora 12:00. Ky vendim nuk është ankimuar.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari në datën 22.5.2014, pas 7 ditësh nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 28 ditë, në intervalin kohor 17.4.2014 – 15.5.2014 nga data e shortit. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9-mujor të përcaktuar nga pika 5, germë “a”, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit<sup>5</sup>. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar të përcaktuar nga pika 2, e neni 28, të Kushtetutës dhe pika 3, e neni 5, të KEDNj-së.

Eshtë caktuar dhe janë zhvilluar tri seanca gjyqësore, të cilat kanë qënë produktive, ku janë kryer veprimet procedurale për zgjidhjen e çështjes dhe në përfundim të seancës është disponuar me vendim që ka përfunduar shqyrtimin e çështjes.

Vendimi që ka përfunduar çështjen përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

**Dosja 3.** Çështja civile nr. \*\*\* regjistri, datë 7.7.2015 regjistrimi, që i përket paditësit Th.H, të paditur përmbaruesen gjyqësore private A.Gj dhe B.L, me objekt “kundërshtim i veprimeve përmbarimore”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2015.

Çështja është regjistruar në gjykatë më 7.7.2015. Me shortin e datës 8.7.2015 i është caktuar gjyqtarës Matilda Llangozi. Me vendim të datës 8.7.2015, gjyqtarja ka vendosur caktimin e seancës përgaditore në datën 13.7.2015, ora 13:00.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari në datën 28.10.2015, pas 7 ditësh nga shpallja, brenda afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 3 muaj e 13 ditë, në intervalin kohor 8.7.2015 – 21.10.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Janë zhvilluar pesë seanca, nga këto tri përgatitore dhe dy gjyqësore. Seancat gjyqësore kanë qenë produktive. Procesverbali për seancat është i rregullt dhe në përfundim të saj është disponuar me vendim përfundimtar të çështjes.

Vendimi gjyqësor është strukturuar sipas elementeve të parashikuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile.

**Dosja 4.** Çështja civile nr. \*\*\* regjistri, datë 19.6.2014 regjistrimi, që i përket kërkueses I.C, person i tretë V.Gj, me objekt “lëshimin e autorizimit prej gjykatës për fëmijën B. Gj për daljen jashtë shtetit i shoqëruar nga nëna e tij, kërkuesja”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.10.2014.

Çështja është regjistruar në gjykatë dhe me shortin e datës 25.6.2014, i është caktuar gjyqtarës Matilda Llangozi. Me vendim të datës 26.6.2014, gjyqtarja ka vendosur caktimin e seancës përgatitore në datën 14.7.2014, ora 12:30.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari në datën 6.10.2014, pas 4 ditësh nga shpallja, brenda afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 3 muaj e 7 ditë, në intervalin kohor 25.6.2014 - 2.10.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, pika 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Janë zhvilluar 7 seanca, nga këto 3 përgatitore dhe 4 gjyqësore. Seancat gjyqësore kanë qenë produktive.

Vendimi gjyqësor është strukturuar sipas elementeve të parashikuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile: pjesa hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës. Vendimi paraqitet me strukturë të qartë.

**Dosja 5.** Çështja penale nr. \*\*\* regjistri, datë 25.2.2016 regjistrimi, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me objekt “vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi ‘arrest në burg’ ndaj të dyshuarit J.Ç për veprën penale të goditje për shkak të detyrës, të parashikuar nga neni 237 të Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2016.

Çështja është regjistruar në gjykatë dhe me shortin e datës 25.2.2016 aktet i kanë kaluar subjektit të rivlerësimit Matilda Llangozi, në cilësinë e gjyqtarës së gatshme. Gjyqtarja Matilda

Llangozi, me vendimin e datës 25.2.2016 ka caktuar seancën gjyqësore në datën 26.2.2016, ora 9:30.

Gjykata Apelit Vlorë, me vendim nr. \*\*\*, datë 13.4.2016, ka vendosur: miratimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 26.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsytuar janë depozituar në sekretari në datën 2.0.2016, pas 4 ditësh nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga 113 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 20 orë e 25 minuta, në intervalin kohor 25.2.2016, ora 14:56 - 26.2.2016, ora 10:29. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 48 orë nga paraqitja e kërkesës në gjykatë, të parashikuar në nenin 259/5 të Kodit të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar të përcaktuar nga pika 2, e nenit 28, të Kushtetutës dhe pika 3, e nenit 5, të KEDNj-së.

Është caktuar dhe zhvilluar një seancë gjyqësore produktive, ku janë kryer veprimet procedurale për zgjidhjen e çështjes dhe në përfundim të seancës është disponuar me vendim që ka përfunduar shqyrtimin e çështjes.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga neni 245 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

#### **Vlerësimi i bërë nga Komisioni.**

Për gjyqtaren Matilda Llangozi, në tri dokumentet ligjore të prezantuara prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Rastet e vëzhguara tregojnë se ka shqyrtuar çështje gjyqësore që lidhen me parashkrimin e ekzekutimit të vendimit penal, lidhur me ndëshkimin moral dhe material për gjyqtarin, si dhe vepra penale që lidhen me drejtimin e automjetit në mënyrë të parregullt, atë të vjedhjes së energjisë elektrike dhe kundërshtim i veprimeve përmbarimore.

Gjyqtarja Matilda Llangozi ka njohuri për parimet themelore të procesit gjyqësor penal e civil, jo vetëm që i përdor gjatë gjykimit, por në arsyetimin e vendimit gjenden raste ku iu referohet parimeve në zbatimin e ligjit.

Ajo vlerëson dhe i kushton rëndësi dënimit të të pandehurit me burgim dhe pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, në njërin rast për veprën penale të drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt dhe në dosjen dy i pandehuri akuzohet për vjedhje të energjisë elektrike, apo kur objekti i padisë lidhet me kundërshtimin e veprimeve përmbarimore të përmbarueses gjyqësore dhe kur objekti i kërkesës lidhet me lëshimin e autorizimit prej gjykatës për fëmijën e mitur, për daljen jashtë shtetit i shoqëruar prej nënës së tij.

Identifikon rastin, kur duhet përdorur ligji specifik, për çështje qoftë për çështje materiale apo procedurale. Në ndonjë rast, ka përdorur edhe referenca në legjisllacionin e posaçëm. Gjyqtarja ka përdorur referenca në një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, si dhe i referohet qëndrimit të mbajtur Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 27.5.2004, ku është rikonfirmuar qëndrimi se “gjyqtari betohet se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndrojë kurdoherë besnik kushtetutës, ligjeve dhe do të respektojë rregullat e etikës profesionale”.

Ajo njeh dhe zbaton mirë parimin për ndëshkimin moral dhe material për gjyqtarin, procedurën për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor, parimin për lëshimin e autorizimit nga gjykata për fëmijën e mitur për daljen jashtë shtetit i shoqëruar nga nëna, si

dhe parimin e detyrimit të gjykatës për të cilësuar saktë mosmarrëveshjen, kur kërkohet detyrimi i të kundërpaditurve (paditësive) të lirojnë dhe dorëzojnë sendin, ku një vend të veçantë në arsyetimin e vendimit gjykata është referuar në nenet 168-170 të Kodit Civil, të cilat bëjnë fjalë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues.

Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën kushtetuese, civile e penale, ku bien në sy në një çështje të gjykuar prej gjyqtarës referimi në ligjin “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se funksioni i gjyqtarit është një funksion dhe detyrë që është parashikuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe konkretisht neni 7, ku thuhet se “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se funksioni i gjyqtarit është një funksion dhe detyrë që është parashikuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutiv dhe gjyqësor”.

Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 4 vendime, dokumenti 1 dhe 2, dhe dosjet 1 dhe 5, nga të cilat 4 vendimet janë lënë në fuqi nga gjykata e Apelit.

Subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standartizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjykata. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Struktura e vendimeve të saj është e standardizuar. Ajo përmban në mënyrë të përgjithshme elementet e kërkuara nga legjislacioni procedural civil e penal. Kështu, në pjesën hyrëse të dokumenteve 1-3 dhe dosjet 1-5, janë shënuar gjeneralitetet e plota të palëve ndërgjyqëse dhe objekti dhe akuza e plotë, si dhe baza ligjore përkatëse.

Pjesa arsyetuese hartohet me gjuhë të thjeshtë dhe me strukturë solide. Në dokumentet 1-3 dhe në dosjet 1-5, arsyetimi nuk është strukturuar me nënpjesë të emëtuara me tituj, por paragrafët nuk janë uniformë dhe ka raste që paraqiten me tekst të gjatë dhe me citim të plotë të përmbajtjes së normave të ligjit të zbatueshëm, që rëndojnë qartësinë e tekstit.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar i jep përgjigje pretendimeve të palëve. Gjatë arsyetimit të vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Analiza ligjore është e thjeshtë, mjaftohet me tregimin e dispozitave ligjore të zbatueshme dhe me konkluzionin e zbatimit të tyre, duke përdorur fjali përgjithësuese.

Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, tregohet e drejta e ankimit për palët.

Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin përfundimtar.

Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat në asnjë rast nuk mungon shkak ligjor.

Subjekti rivlerësimit Matilda Llangozi, në periudhën e rivlerësimit 4.11.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Lidhur me ngarkesën sasiore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 1272 çështje dhe ka përfunduar 1193 çështje, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 76 çështje.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, gjyqtarja e gjykatës së rrethit gjyqësor është subjekt ndaj të cilës zbatohet vendimi nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, i ish-KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve, Aneksi 1, “Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Rrjedhimisht, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të këtij vendimi dhe të ligjit procedural për çështje të veçanta. Për aspektin sasior pikës 3, germa “ë”, të vendimit të ish-KLD-së, gjyqtari i gjykatës i seksionit civil e penal shqyrton jo më pak se 400 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me çështje të natyrës kërkesa (civile ose penale) me ose pa palë të interesuara.

Rrjedhimisht, bazuar në të dhënat e mësipërme mesatarja e gjykimit për subjektin Matilda Llangozi është 394 çështje penale e civile në tri vite, *rezultoi se gjyqtarja Matilda Llangozi ka përballuar një volum të lartë pune.*

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se, për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja Matilda Llangozi ka përfunduar gjithsej 1079 çështje gjyqësore, nga të cilat 438 çështje penale, 509 çështje civile.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Matilda Llangozi ka qenë në intervale kohore nga 20 orë e 25 min , deri në 5 muaj e 10 ditë. Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 28 ditë, 3 muaj e 7 ditë dhe 3 muaj e 13 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, prej 5 muaj e 10 ditë, ka qenë çështje penale themeli dhe në përfundim është disponuar me vendim themeli, por seancat gjyqësore janë shtyrë me kërkesë të prokurorisë për të njoftuar të pandehurin dhe koha që kanë kërkuar palët për të paraqitur konkluzionet përfundimtare.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Matilda Llangozi janë paraqitur 4 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, 3 në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016: 1 ankesë e vitit 2015 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se nuk përmban fakte dhe rrethana në verifikim; 1 e vitit 2015 verifikuar për shkelje të etikës dhe moszbardhje vendimi, e cila i është regjistruar gjyqtares për efekt të vlerësimit profesional dhe etik; 1 ankesë e vitit 2015 është e përsëritur; si dhe 1 ankesë e vitit 2016 verifikuar për zvarritje gjykimi, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimit profesional dhe etik. Për gjyqtaren Matilda Llangozi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, rezultoi që ndaj saj të ketë ardhur një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë për procedim disiplinor (kërkesa mban nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2015, regjistruar në ish-KLD, me nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2015) për “shkarkim nga detyra”, është trajtuar në mbledhjen e ish-Këshillit, të datës 24.1.2018, ku edhe është rrëzuar. Nuk është propozuar masë tjetër disiplinore.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 4 ditë (afati më i shkurtër) dhe në 14 ditë (afati më i gjatë). Ndër 5 dosjet e vëzhguara, 2 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm, ndërsa 3 vendime brenda afatit ligjor. Vendimi që është arsyetuar me vonesën prej 14 ditësh, ka qenë çështje penale themeli, me të cilin është disponuar me vendim themeli përfundimtar dhe është lënë në fuqi nga gjykata e apelit.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi përgjithësisht është efektive në punë. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Matilda Llangozi nuk i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatin ligjor në 3 raste nga 5 vendime. Vetëm në 2 raste është tejkaluar afati ligjor. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 7 ditë nga shpallja dhe për 14 ditë nga shpallja.



Kohëzgjatja e gjykimit në 3 dokumentet ligjore ka qenë 1 muaj e 20 ditë dhe 10 muaj e 23 ditë, ndërsa në dokumentin 2 nuk është shënuar data e regjistrimit.

Subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si akti formal i gjyqtarës për kalimin e çështjes në seancë përgatitore apo gjyqësore, në dosje përfshihen kopjet e fletëthirrjeve për palët ndërgjyqëse, për të dokumentuar datën e njoftimit për gjykim, procesverbali i seancave, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil. Në pesë dosjet e vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Matilda Llangozi. Për gjyqtaren Matilda Llangozi në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.

## DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit Matilda Llangozi janë paraqitur denoncime, të trajtuara dhe analizuar si vijon:

**1.** Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2020, i shtetasit L.S, i cili ka denoncuar edhe subjekte te tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, *për dhënie vendimesh të padrejta dhe skandaloze nga pikëpamja profesionale*. Nga studimi i akteve ligjore të sjella bashkëlidhur ankesës së denoncuesit nuk rezultojnë *indicie* lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit.

**2.** Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2021, i shtetasit E.S, i cili ka paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat një kërkesë për përjashtimin e trupës gjyqësore, me gjyqtare Matilda Llangozi dhe këtë kërkesë për dijeni ia ka dërguar edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Referuar Kodit të Procedurës Civile mbetet në kompetencën dhe përgjegjësinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat shqyrtimi i kësaj kërkesë në funksion të kushteve për përjashtim të një gjyqtari apo të trupës gjyqësore të shortuar për gjykim nga po ajo gjykatë.

**3.** Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021, i shtetasit A.P, i cili ka bërë denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit në vitin 2018, *për një vendim absurd dhe të pabazuar në prova e në ligj*. Më tej, në kërkesën e tij, ky shtetas është shprehur se *gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë ndryshuar këtë vendim të shkallës së parë dhënë nga gjyqtare M. Llangozi*. Më pas, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.7.2021, ky shtetas denoncon përsëri gjyqtaren Matilda Llangozi, ku ankohet se: *“Gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore prej saj janë lejuar shumë shkelje procedurale të ligjit, të cilat më kanë dëmtuar mua si individ dhe kanë shkatërruar marrëdhënien time si prind me fëmijën tim, pasi për një kohë të gjatë nuk kam pasur kontakt me fëmijën tim për shkak të kërcënimit të gjyshërve të tij. Pas vdekjes së bashkëshortes sime nga një sëmundje e pashërueshme, fëmijën tonë të mitur e marrin në mënyrë të kundërligjshme gjyshërit e tij (ish-vjehrrit dhe ish -vjehrra ime). I jam drejtuar Gjykatës Berat, ku kam kërkuar ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe kthimin e fëmijës. Pas zhvillimit të disa seancave gjyqësore ish-vjehrrit paraqiten në gjykatë me kundërpadi, ku kërkonin të më hiqnin*

*përgjegjësini prindërore dhe t'u lihej për edukim e rritje fëmija im i mitur. Në funksion të gjyqimit që po zhvillohej në gjykatën e rrethit Gjyqësor Berat, gjyqtarja Matilda Llangozi cakton një eksperte psikologe për të kryer vlerësimin psikologjik se me kë duhet të rrijë fëmija im dhe konkretisht ajo thërret psikologun B.Z, një person i paregjistruar në regjistrin tregtar dhe i palicencuar nga Urdhri i Psikologut duke kryer detyrën e saj në shkëlqje flagrante me ligjin, gjë të cilën e ka lejuar gjyqtarja e çështjes Matilda Llangozi”.*

Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me kërkesën për informacion dhe ecurinë e kësaj çështjeje në të tri shkallët e gjyqësorit, si dhe informacionin nëse shtetasja B.Z, në cilësinë e psikologes së çështjes, ka qenë e regjistruar si eksperte në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka dërguar kopje të praktikës gjyqësore dhe vendimet gjyqësore për çështjen familjare më palë A.P, D.T, K. T, me objekt “kthimin e fëmijës së mitur dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore”, e cila, pasi ka përfunduar në Gjykatën e Lartë, është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Vërehet se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka shqyrtuar çështjen me palë paditëse/i kundërpaditur A.P, denoncuesi, babai biologjik i fëmijës së mitur A. P., palë të paditur/kundërpaditës K.T, gjyshi i fëmijës së mitur dhe palë e tretë D.T (gjyshja e fëmijës së mitur), me objekt “kthimin e fëmijës së mitur dhe ushtrimi i përgjegjësisë prindërore dhe objekt kundërpadie”, “heqje e përgjegjësisë prindërore shtetasit A.P dhe caktimin e shtetasës D.T (gjyshja e fëmijës së mitur) si kujdestare të fëmijës së mitur A.P.” Në fund të procesit gjyqësor, gjyqtarja Matilda Llangozi, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2017, vendosi: *“Pranimin pjesërisht të padisë së paditësit A P; bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, fëmija A. P. lejohet që të qëndrojë me gjyshërit e tij nga nëna K e D T; i padituri A P ka të drejtë të takojë fëmijën e tij A. P. në prezencën e gjyshit të tij K T... etj. ”.*

Pas ankimit të vendimit nga babai i fëmijës së mitur A. P, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.5.2018, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 6.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat lidhur, me objektin e padisë, në këtë mënyrë: lënien për rritje dhe edukim fëmijën A. P., babait A. P; i padituri K.T (gjyshi) dhe personi i tretë D.T (gjyshja) kanë të drejtë të takojnë fëmijën sipas kohës së caktuar nga gjykata”.*

Gjithashtu, Gjykata e Lartë, pas rekursit të ushtruar nga gjyshërit e fëmijës së mitur K dhe D.T, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2020, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 24.5.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Siç vërehet nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, *vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat shihet i gabuar dhe se nuk kishte asnjë shkak që ti hiqej e drejta e kujdestarit ligjor paditësit, babait të fëmijës së mitur A. P, pasi nga të gjitha aktet e administruara rezultojnë me personalitet të mirë dhe kushte normale për banim dhe siguron të ardhura për rritjen dhe edukimin e fëmijës.*

Ndërsa, në lidhje me faktin nëse shtetasja B.Z ka qenë e regjistruar si eksperte pranë Gjykatës së Rrethit Berat, kancelari i kësaj gjykate konfirmon se *znj. B Z ka qenë e regjistruar si eksperte në listën e ekspertëve të viteve 2015 e 2016 pranë kësaj gjykate.*

Sa më sipër, Komisioni, pas hetimit të dosjes gjyqësore të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, konstaton se gjyqtarja Matilda Llangozi, në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë 6.2.2017, ka lejuar që fëmija i mitur të qëndrojë me gjyshërit, duke anashkaluar prindin baba A. P. të ushtrorë kujdestarinë ndaj fëmijës së tij.

Për këtë fakt, Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë kanë ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me gjyqtare Matilda Llangozi.

Për sa më sipër, në lidhje me rezultatet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Në lidhje me çështjen civile ku palë paditëse ka qenë A P, babai i fëmijës së mitur dhe palë e paditur ka qenë K T gjyshi i fëmijës (nga nëna), me objekt ‘ushtrimi i të drejtës prindërore’, gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2017, ka vendosur: ‘Pranimin pjesërisht të padisë së paditësit A.P. Bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, fëmija A P i biri i A, i datëlindjes 6.8.2014, lejohet që të vijojë të qëndrojë me gjyshërit e tij nga nëna K dhe D.T. I padituri A.P ka të drejtë të takojë fëmijën e tij A.P të dielën e parë të çdo muaji nga ora 10:00 deri në orën 15:00 në prezencën e gjyshit të tij K.T. Rrëzimin e kërtimeve të tjera në kërkesë-padi. Rrëzimin e kundërpadisë të bërë nga K.T si të pambështetur në prova dhe në ligj...’.*

*Gjykata, me vendimin e mësipërm ka gjykuar dhe ka rrëzuar kundërpadinë e depozituar nga gjyshi i fëmijës K.T ndaj shtetasit A.P me objekt ‘Heqja e përgjegjësisë prindërore shtetasit A.P. Caktimin e shtetasës D.T, si kujdestare për fëmijën e mitur A.P’.*

*Në lidhje me ankesën e depozituar nga shtetasi A.P dhe që ka të bëjë me mënyrën e vendimmarrjes sime, Ju bëj me dije se vendimi i marrë prej meje ka qenë një vendim tërësisht i drejtë, i bazuar në vlerësimin e kujdesshëm dhe tërësor të provave të marra gjatë shqyrtimit që kanë qenë provat shkresore, pyetja e dëshmitarëve, pohimet e palëve, si dhe prova me ekspertë, i bazuar në ligj dhe konkretisht në nenin 218 të Kodit të Familjes, si dhe bazuar në bindjen e brendshme të formuar gjatë gjykimit të kësaj çështje.*

*Në nenin 218 të Kodit të Familjes, përcaktohet se: ‘Prindërit mund të kërkojnë nga gjykata kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur nuk jeton pranë tyre dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë. Gjykata, për rrethana të rënda, mund të mos vendosë kthimin, në qoftë se ky vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës. Gjykata merr edhe mendimin e fëmijës kur ka mbushur moshën dhjetë vjeç’.*

*Pra, në bazë të vendimit tim, lënia e fëmijës tek gjyshërit ka qenë me qëllim të përkohshëm në mënyrë që babai duke respektuar vendimin e gjykatës për takimet me fëmijën e tij do të mund të vendoste kontaktet dhe komunikimin me djalin e tij të mitur”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime shteruese mjaft bindëse, të cilat çojnë në konkluzionin e qartë se vendimi që ka dhënë nuk ka synuar që të heqë kujdestarinë e fëmijës nga babai i tij, por ka qenë një zgjidhje për situatën konkrete që babai të fillojë të vendosë kontakte dhe komunikim me fëmijën e mitur për një periudhë të caktuar kohore në mënyrë që më pas të bëhej edhe marrja e fëmijës, kur ky i fundit të kishte një moshë më të madhe.

4. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2019, i shtetasit J.Th.Dh, i cili ka denoncuar edhe subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për dhënie vendimi të padrejtë. Duke studiuar vendimin bashkëlidhur denoncimit konkludohet se nuk rezultojnë *indicie* për hetime të mëtejshme lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë kemi të bëjmë me çështje vendimmarrjeje gjyqësore të ankimeshme.

5. Denoncime të përsëritura nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2019, nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2020, të shtetases L.C (L.J), e cila ka denoncuar edhe subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për dhënie vendimesh të padrejta në lidhje me të drejtën e shkelur të pronës së saj.

Nga studimi i akteve ligjore të sjella bashkëlidhur ankesës së denoncueses, rezulton se vite më parë, nga pothuajse tri shkallët e gjyqësorit, kishte fituar të drejtën ndaj cenimit të pronës së saj nga familja R, duke u shprehur gjykata për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes së pronës nga fqinji i saj I. R. e më pas K. H. (të cilit ia kishte shitur pronën objekt konflikti).

Pavarësisht këtij fakti, duke qenë se prona kishte pësuar transaksione ndër vite, vendimet e gjykatave nuk ishin zbatuar dhe, për rrjedhojë, ankuesja i është drejtuar në vitin 2018 organit të akuzës, me kërkesën e procedimit penal për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” nga zotëruesit e paligjshëm të pronës së saj. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat i kishte kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2018, për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Gjyqtarja Matilda Llangozi, në cilësinë e gjyqtares së seancës paraprake, kontrolluese e dosjes së hetimit paraprak, ka vendosur pranimin e kërkesës nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, datë 12.12.2018, me arsyetimin se nuk është bërë deklarimi si i falsifikuar i dokumentit kontratë shitje - objekt konflikti. Përkundrazi, vite më parë, gjykatat kanë konstatuar pavlefshmërinë e kësaj kontrate për arsye të ndryshme dhe jo për shkak të falsifikimit të ndonjë elementi të saj.

Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka gabuar në vendimmarrjen e saj në lidhje me objektin e shqyrtimit të kësaj kërkesë në seancë paraprake gjyqësore, të shprehur me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.2.2019.

6. Denoncime të përsëritura nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2019, nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2019, të shtetasit A.J, i cili ka denoncuar edhe subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, të cilët gjejnë hapësira ligjore boshe për të ligjëruar kërkesat abuzuese të personave që vënë në lojë drejtësinë shqiptare.

Shtetasi A. J, bashkë me trashëgimtarët e tjerë të shtetasit T.B.J, kanë kërkuar prej vitesh të njihen pronarë mbi disa prona të ndodhura në Skrapar. Në vitin 2009 janë njohur trashëgimtarë ligjorë të gjyshit të tyre. Më pas i janë drejtuar gjykatës për njohje pronar dhe kthim e kompensim të pronës së tyre. Por, trashëgimtarët të ndarë në dy grupe kanë pasur herë pas here konflikte, duke bërë që të përfundojnë nëpër gjyqe. Shtetasi A.J, me trashëgimtarë të tjerë, është kallëzuar nga kushërirat e tij (A.Q dhe M.B) pranë prokurorisë dhe vendimi i pushimit të çështjes i është përcjellë gjykatës, e cila e ka zvarritur procesin pafund, duke bërë që shumë gjyqtarë me radhë të jepnin dorëheqje pa arsye. Ndër to, edhe subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.5.2019, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ndërkohë që zv/kryetari i gjykatës me vendimin nr. \*\*\* prot., të datës 3.4.2019, nuk e kishte pranuar të njëjtën kërkesë.

Çështja është rishortuar dhe përsëri dy gjyqtarët të tjerë kanë kërkuar heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, duke bërë që çështja të zvarritet. Gjykata, sipas denoncuesit, ka “ligjëruar” arsyetimet e saj për pranimet për heqje dorë ose përjashtime se, humbja e besimit në zbatimin e drejtësisë përbën shkak që një trup gjykues të mos zbatojë detyrat sipas ligjit.

Por, denoncuesi sqaron se: *“Në fund kjo ka shkaktuar jo vetëm dëm të personit tim, duke qenë se unë jam i kallëzuar nga këto dy zonja (kushërirat e mia) dhe në këto kushte po mbahet peng karriera ime profesionale, por edhe nuk po gjen zgjidhje e drejta jonë e pronës”.*

Ndërkohë, një formular tjetër, denoncimi nr. \*\*\*, datë 9.7.2021, ka mbërritur pranë Komisionit, ku denoncuesja A.Q (njëra prej kushërirave të A.J)ka denoncuar subjekte të tjera, por ndër to edhe gjyqtaren Matilda Llangozi, ku kërkon që të merren masa për gjyqtaren si e padenjë për funksionin që ajo mban.

Për sa më sipër, në lidhje me rezultatet e Komisionit, subjektit të rivlerësimit ju kërkua të jepte shpjegime në lidhje denoncimin e paraqitur nga pala kundërshtare në procesin penal.

### **Qëndrimi i subjektit**

Subjekti sqaron se: *“Në datën 5.2.2019, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka ardhur për gjykim kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, me objekt: kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*. Shqyrtimi gjyqësor i kësaj kërkesë është bërë për një periudhë prej 10 muajsh. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë gjyqtarja L. Ç, e cila ka qenë e deleguar në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për shqyrtimin e kësaj çështjeje ka vendosur:... 1. Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 13.7.2018, të regjistruar për veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. 2. Kthimin e akteve organit të akuzës dhe vazhdimin e hetimeve, të përshkruara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, pasi çmon se ato janë të paplota. 3. Këto hetime duhet të përfundojnë brenda një afati 3-mujor nga momenti i marrjes formë të prerë të këtij vendimi. ... Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 6.1.2020. Si palë ndërgjygjëse në këtë gjykim kanë qenë Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, përfaqësuar nga prokurori D.G dhe kallëzueset A.Q (J) dhe M.B (J).*

*Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje penale për shkak të qenies si gjyqtare e gatshme në periudhat përkatëse, më është dashur të shqyrtoj kërkesat e kërkueseve A.Q (J) dhe M.B (J) për përjashtimin e trupës gjyqësore që kishte në shqyrtim çështjen penale të sipërcituar në tre raste, ku për secilin rast kam vendosur në përputhje me ligjin procedural penal.*

*Ndërsa, në lidhje me ankesën e depozituar nga shtetasi A.J, theksoj se kjo ankesë nuk qëndron, pasi ky shtetas nuk ka pasur asnjë pozitë procedurale në procesin penal të sipërcituar dhe që ka qenë shqyrtimi në seancë paraprake i kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit penal të regjistruar për veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’ të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Regjistrimi i kësaj veprë penale është pa autor.*

*Edhe gjatë hetimeve paraprake ky shtetas nuk ka pasur asnjë pozitë procedurale si person nën hetim apo i pandehur që të jetë i ndërvlarur nga zgjatja e procesit të mësipërm dhe mënyra e përfundimit të tij. Në të tilla kushte nuk mund të pretendohet prej tij dëmtimi i karrierës apo imazhit të tij”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me ankesën e shtetasit A.J, ka dhënë shpjegime shteruese bindëse. Subjekti ka marrë disa vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga ankueset A.Q (J) dhe M. B (J) për përjashtimet e gjyqtarëve. Ndërsa ankuesi A.J, kushëriri i ankueseve më sipër, nuk ka pasur asnjë pozitë procedurale si person nën hetim apo i pandehur që të ketë qenë i ndërvlarur nga zgjatja e procesit dhe mënyra e përfundimit të tij. Në të tilla kushte, nuk mund të pretendohet prej tij dëmtimi i karrierës apo imazhit të tij.

7. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020, i shtetasit M.K, i cili ka denoncuar shumë subjekte të tjera nga gjyqësori, organet ekzekutive etj., ku përmend emra pafund, të cilët kishin të bënin me denoncuesin në çështjet e tij të shumta ku ai ishte palë.

Nuk rezultojnë situata konkrete e shkelje konkrete lidhur me subjektin e rivlerësimit.

8. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2021, i shtetasit J.M, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit: *“Për shkak se është në proces gjyqësor civil, e ku pas 4 muajve më njoftojnë në datën 29.9.2021 se do paraqitem në gjyq, por në korridorin e gjykatës del sekretarja I. Q., e cila më njofton se seanca nuk do të zhvillohet por do paraqitesh pas dy muajve, në datën 24.11.2021. Deri tani kanë kaluar më shumë se 6 muaj, ju lutem çfarë të bëj!?”* Kështu e mbyll ankimin denoncuesi.

Ndodhur në këto kushte, kur çështja është në proces gjykimi nuk mund të hetojmë mbi mundësinë e shkeljeve konkrete për subjektin e rivlerësimit.

9. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, i shtetasit K..M, i cili ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin Matilda Llangozi. Denoncuesi ankohet *“Për pranimin e një padie të padrejtë, ku gjyqtarja M. Llangozi, disa gjyqtarë të gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe disa drejtorë të hipotekës Berat etj. duhet të hetohen për shkelje të ligjit të ndarjes së tokës, për falsifikime për marrje rryshfeti sepse në mënyrë korruptive vëllai i tij ka përvetësuar në mënyrë të padrejtë pronë prej 12 dynym tokë, ndërkohë që ka qenë i shpërngulur në atë kohë nga fshati-komuna \*\*\*. Këtë e ka bërë duke falsifikuar firmën time, duke përpiluar testamente të nënës së ndjerë, duke marrë firmën e dy motrave tona e duke paguar drejtorët e hipotekës Berat”*. Kështu denoncuesi shprehet se: *“Në këtë përvetësim të padrejtë të tokës me certifikatë prej 12 dy tokë, janë edhe gjyqtarët e apelit, noterja, avokatja etj., të cilët duhet të ndiqen penalisht e të shkarkohen”*.

Nga ankimi vërehet se vëllai i denoncuesit R.M ka paditur dy vëllezërit e tij F.M dhe K.M (denoncuesin) për pjesëtimin e pasurive në bashkëpronësi të palëve ndërgjyqëse. Denoncuesi shprehet se: *“Kjo gjykatë ka marrë vendim kundra meje për pjesëtim pasurie me dy vëllezërit e mi, sepse personi nuk mund të përfitojë tokë në pronësi me ligjin nr. 7501 për arsye se nuk është në përbërjen familjare”*.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.12.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, vendim i cili duket se i ka dhënë të drejtë palës paditëse, ku më pas denoncuesi ka ushtruar të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë. Për shkak të metave të rekursit (mungesa e nënshkrimit nga një avokat) është kthyer pa veprime ky rekurs civil.

Për sa më sipër, për sa kohë kjo është çështje që Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, si dhe situata konkrete ka të bëjë më tepër me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit, se sa me konstatim shkeljesh procedurale, konkludohet se nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioni, pasi kreu hetim të hollësishëm mbi këto denoncime, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, arriti në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

### **Konstatime të tjera në lidhje me indicie të mbërritura në Komision për subjektin e rivlerësimit Matilda Llangozi**

Komisioni, në lidhje me këto *indicie*, bëri hetim për të gjitha çështjet që kishin të bëjnë me subjektin e rivlerësimit, dhe në përfundim rezultoi, si vijon:

## **1. Dosja penale nr. \*\*\* vendimi, datë 12.3.2015, me të pandehur E.T**

Për dosjen penale nr. \*\*\* regjistri, datë 26.1.2015, që i përket kërkuesit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe të pandehur E.T, akuzuar për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe shitje e narkotike” dhe “kultivim i bimëve narkotike”, të parashikuara nga nenet 283/1 dhe 284/1 të Kodit Penal, gjyqtarja Matilda Llangozi vendos ta kalojë çështjen në seancë gjyqësore publike, në datën 11.2.2015, ora 11:00. Për realizimin e seancës gjyqtarja ngarkon sekretarinë të realizojë njoftimet e prokurorit, të pandehurit pranë I EVP-së Berat dhe të anëtarëve të trupës gjyqësore.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.3 2015, trupi gjykues, i përbërë nga gjyqtarët Malitlda Llangozi k/seance, Sh.Ç dhe A.V, kanë vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe shitja e narkotikëve’, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit E.T për kryerjen e veprës penale ‘kultivim të narkotikëve’, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve të dhëna, i pandehuri E.T dënohet me 5 (pesë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 masa e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri E.T dënohet me 3 (tre) vjet e 4 ( katër) muaj burgim, etj.”.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, si dhe i pandehuri E.T, dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.6.2015, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 12. 3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me ndryshimin: në aplikim të nenit 55/1 të Kodit Penal dënimin e të pandehurit E. T me një dënim të vetëm prej 6 (gjashtë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale e dënon të pandehurin E.T me 4 (katër) vjet burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë”.

## **2. Dosja penale nr. \*\*\* vendimi, datë 31.5.2016, me kërkues E.K**

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, gjyqtarja e vetme Matilda Llangozi ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë, në bazë të neneve 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” në bazë të neneve 228, 229 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Në fund të shqyrtimit, gjyqtarja ka vendosur: “Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit nën hetim E.K, i dyshuar për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe shitje të narkotikëve’, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe caktimin ndaj shtetasit nën hetim E.K, masën e sigurimit personal ‘arrest me burg’, etj.”. Ndërkohë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.5.2016, gjyqtarja Matilda Llangozi ka pranuar kërkesën e kërkuesit E. K dhe ka vendosur: “Zëvendësimin e masës së sigurimit ‘arrest me burg’, të vendosur ndaj shtetasit E.K, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me masën e sigurimit ‘detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore të enjten e parë të çdo muaji në orën 11:00’, etj.”.

Ndërkohë, në datën 26.7.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal në ngarkim të të hetuarve Gj.L, E.K dhe K.K.

#### **Dosja penale nr. \*\*\* vendimi, datë 26.11.2017, me kërkues A.M**

Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 8.3.2018, bashkëlidhur edhe vendimi nr. \*\*\*, datë 20.2.2019, i Gjykatës së Lartë.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11.2017, gjyqtarja Matilda Llangozi ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës penale së bërë nga kërkuesi A.M për përjashtimin e gjyqtarëve D.H, R.P dhe A. V nga gjykimi i çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.M, i cili akuzohet për kryerjen e veprës penale ‘vjedhje me pasojë vdekjen’, parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal”. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi A.M. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.2.2019, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi A.M, kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 26.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat”.

#### **4. Dosja penale nr. \*\*\* vendimi, datë 26.6.2019, me të pandehur S.T**

Gjyqtarja e vetme Matilda Llangozi ka gjykuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit S.T, akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, ku, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.6.2019, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit S.T, për kryerjen e veprës penale ‘vjedhje duke shpërdoruar detyrën’ dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim”.

Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit e masës së dënimit të dhënë dhe në përfundim i pandehuri S.T dënohet me 4 (katër) muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burg për dënimin e dhënë prej 4 (katër) muaj, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë prej 8 (tetë) muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte më Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Berat.

Ky vendim ka marrë formë të prerë.

#### **5. Dosja penale nr. \*\*\* vendimi, datë 25.6.2018, me të pandehur V.R**

Në kuadër të procedimit penal për dy shtetasit S.K dhe V.R Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka hetuar çështjen penale, me akuzën për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat gjykimin e këtyre dy shtetasve për këtë vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me gjyqtare Matilda Llangozi, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.6.2018, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit V.R për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe shitje e narkotikëve’, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim”.

Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 masa e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri V.R dënohet me 3 (tre) vjet e 4 ( katër) muaj burgim.

Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim dy të pandehurit V.R dhe S.K dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.10.2018, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 25.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat”.

Ky vendim ka marrë formë të prerë.

#### **6. Dosja penale nr. \*\*\*, datë 19.3.2018, që i përket çështjes me të pandehur K.D e të dëmtuar G.M, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka shqyrtuar çështjen me kërkues Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe të pandehur K.D, akuzuar për kryerjen e veprave penale “mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve, armëve shpërthyesë dhe të municionit” dhe “kanosjes”, të parashikuara nga nenet 278/1 dhe 84 të Kodit Penal, ku në përfundim të shqyrtimit me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.3.2018 ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të**



pandehurit K.D për kryerjen e veprës penale ‘mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve, armëve shpërthyes dhe të municionit’, të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit K.D për kryerjen e veprës penale ‘kanosjes’, të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve të dhëna, i pandehuri K.D dënohet me 4 (katër) vjet burgim”.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri K.D dënohet me 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për periudhën e pavuajtur prej 2 (dy) vjet, 5 (pesë) muaj e 20 ditë dhe vënia e të pandehurit në periudhë prove prej 3 (tre) vjet, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte më Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Berat.

Në aplikim të neneve 389 dhe 261/b të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet shuarja e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhënë ndaj të pandehurit K.D me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 13.6.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë..

Ndaj këtij vendimi rezulton të kenë ushtruar ankim palët sepse verifikohet se kjo dosje është nisur në Gjykatën e Apelit Vlorë, në datën 13.4.2018, dhe ndodhet në këtë gjykatë, për shkak se nuk ka përfunduar gjykimi i saj.

#### **7. Dosja penale nr. \*\*\* vendimi, datë 22.10.2019, me palë J.S, A.S dhe S.S**

Çështja gjyqësore në ngarkim të të pandehurve J.S, A.S dhe S.S në dëm të shtetasit V.S, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje” të kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4, dhe neni 25 i Kodit Penal është gjykuar nga gjyqtare e vetme Matilda Llangozi, e cila në fund të procesit të zakonshëm të gjykimit ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit J.S për kryerjen e veprës penale ‘dhunë në familje’ të kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4, dhe neni 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim”.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia e të pandehurit J.S në periudhë prove prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte më Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Berat.

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A.S për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje” të kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4, dhe neni 25 i Kodit Penal, pasi nuk u provua se e ka kryer veprën penale për të cilën u akuzua.

Deklarimin fajtor të të pandehurit S.S për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje” të kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 130/a, paragrafi 4, dhe neni 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia e të pandehurit J.S në periudhë prove prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte më Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Berat.

Brenda afatit ligjor të ankimit, palët në proces kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe më pas kanë hequr dorë nga ankimi dhe gjykata, në referim të neneve 418 dhe 420 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: “Mospranimin e ankimit”.

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ka marrë formë të prerë.

Nga studimi i vendimeve dhe praktikave përkatëse, në referim të dispozitave të Kodit Penal dhe atij Procedural Penal, nuk u evidentuan shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarës së vetme.

Ndërsa, për sa i përket mënyrës së dhënies së masës së dënimit për secilin rast, nuk konstatohet favorizim apo dhënie e një dënimi më të ulët se sa parashikon dispozita përkatëse ligjore në fuqi.

Pra, përfundimisht, Komisioni pas mbylljes së rezultateve të hetimit, referuar dyshimeve të përcjellja nga organe ligjzbatuese, nga shqyrtimi i të gjitha fakteve e rrethanave në dosjet gjyqësore të sipërcituara, nuk rezultoi asnjë *indicie* e vetme që të mund të implikonte subjektin e rivlerësimit.

## **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

### **Për vlerësimin e pasurisë**

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur dhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **Për vlerësimin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficiente dhe efektive dhe konsiderohet “e aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të gurmës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Përgjigjet e subjektit, lidhur me çështjet e trajtuara nga Komisioni dhe ato të trajtuara nga denoncimet dhe *indicie* të tjera të mbërritura pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kanë qenë korrekte dhe të bazuara në ligj.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha

pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi në tërësi i kriterit të pasurisë dhe vlerësimi profesional, lidhur me çështjet e gjykuara dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të mbledhura, denoncimet, dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Matilda Llangozi ka arritur nivel të mjaftueshëm për kriterin e pasurisë, si dhe nuk ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Marie Tuma, referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Matilda Llangozi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.12.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Roland ILIA**  
**Relator**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*